

PROSPEKT

Fondi i Pensionit me Pjesëmarrje të Hapur “Master Pension Fund”

*Miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
me Vendimin nr. 93, date 30.06.2025*

Prospekti i Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” (në vijim “Fondi”) i jep anëtarëve të mundshëm dhe kontribuesve një paraqitje të rregullave të Fondit, qëllimit dhe parimeve të investimit të Fondit, si dhe i ndihmon ata të marrin vendimin për të investuar në këtë Fond. Prospekti i fondit të pensionit nuk përfaqëson ftesë për anëtarësim në fond, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat, rreziqet që mbart anëtarësimi në fondin e pensionit privat.

Të gjithë anëtarët e mundshëm dhe kontribuesit që kanë qëllim të anëtarësohen në Fondin e Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” këshillohen të lexojnë me kujdes informacionin e paraqitur në Prospektin e Fondit, në mënyrë që të kenë një informacion të plotë mbi tiparet dhe rreziqet ndaj të cilave ekspozohet Fondi përpara së të marrin vendimin për tu anëtarësuar në këtë fond.

Prospekti i vihet në dispozicion anëtarit pa pagesë, në formë të shtypur në letër përpara nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit ose deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, dhe sipas kërkesës i mundësohet edhe në format elektronik nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi. Prospekti i përditësuar vendoset gjithashtu për tu shkarkuar në një vend të dukshëm në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

Informacioni mbi anëtarët e Fondit është tërësisht konfidencial.

Organizimi dhe administrimi i fondit të pensionit kryhet ekskluzivisht nga shoqëria administruese e fondit të pensionit privat si pjesë e veprimtarisë së shoqërisë “Credins Invest” sh.a..

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për përmbajtjen e prospektit të fondit të pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund”.

Hartuesit e Prospektit kanë treguar kujdes maksimal që informacioni në prospekt të jetë i saktë, dhe nëse ka mungesa informacioni nuk do të ketë humbje materiale mbi rezultatin e pjesëmarrjes në Fond. Shoqëria Administruese është përgjegjëse për sa më lart.

Aktivet e fondit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruese.

Aktivet e fondit të pensionit veçohen nga aktivet e shoqërisë administruese dhe nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit të shoqërisë administruese dhe se fondi nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit; procedurës së falimentimit; procedurës së falimentimit; procedurës së falimentimit. Aktivitetet e Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur ruhen të ndara nga aktivet e Fondëve të tjera që Shoqëria ka nën administrim, si edhe nga aktivet e Shoqërisë Administruese.

Fondi i pensionit privat me pjesëmarrje të hapur është me kontribute të përcaktuara, ku përfitimet nuk janë të garantuara. Si rrjedhojë rrezikun e investimit në fond e mbart Anëtar.

Shoqëria administruese është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj anëtarëve të fondit të pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” nga veprimet ose mosveprimet e saj, nëse dokumentet ose informacioni i parashikuar në këtë Prospekt përmbajnë të dhëna dhe informacione të pavërteta, ose të paplota.

Në këtë prospekt përshkruhen karakteristikat e Fondit të pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund”.

Shoqëria administruese vë në dispozicion të çdo personi që dëshiron të bëhet anëtar i fondit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund”, prospektin e fondit.

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....	4
1.1	OBJEKTI I AKTIVITETIT	4
1.2	FONDET NËN ADMINISTRIMIN E SHOQËRISË CREDINS INVEST SH.A.	4
1.3	DETAJE TË PËRGJITHSHME TË FONDIT:.....	6
1.4	TË DHËNA KRYESORE TË FONDIT	7
2.	INFORMACION PËR ANËTARËT.....	7
3.	ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË INVESTIMIT	7
3.1	PROFILI I INVESTIMIT TË FONDIT	8
3.2	ALOKIMI STRATEGJIK I AKTIVEVE.....	9
3.3	KUFIZIMET E INVESTIMIT	11
4.	ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RREZIKUT	12
4.1	RREGULLAT E MENAXHIMIT TË RREZIKUT.....	12
4.2	IDENTIFIKIMI I RREZIKUT.....	13
4.2.1	RREZIQETË LIDHURA ME INVESTIMIN	13
4.2.2	RREZIQE TË TJERA.....	15
5.	PËRLOGARITJA E VLERËS NETO TË AKTIVEVE	16
6.	PERFORMANCA E FONDIT DHE PUBLIKIMI.....	18
6.1	DOKUMENTACIONI I FONDIT DHE INFORMIMI I PUBLIKUT	18
7.	TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	18
8.	TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT	19
9.	KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT	20
10.	TATIMI	21
10.1	REGJIMI TATIMOR I FONDIT TË PENSIONIT	21
10.2	TRAJTIMI FISKAL I KONTRIBUTEVE TË BËRA NGA PUNËDHËNËSI	21
10.3	TRAJTIMI FISKAL I PAGESAVE TË MARRA NGA ANËTARI	22
11.	PAGESAT E PENSIONIT PRIVAT	22
11.1	PAGESA E PENSIONIT	22
11.2	PAGESA E PENSIONIT PËRMES SHOQËRISË SË SIGURIMIT TË JETËS	23
11.3	TËRHEQJA E PARAKOHSHME	23
11.4	PROCEDURA PËR TËRHEQJEN E AKTIVEVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE	24
11.5	FONDI I PENSIONIT PRIVAT ËSHTË I TRASHËGUESHËM.....	24
12.	PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT.....	25

13. REFUZIMI I ANËTARËSISË.....	25
14. TRANSFERIMI I AKTIVEVE TË ANËTARIT	25
15. BASHKIMI, NDARJA DHE SHNDËRRIMI I FONDIT TË PENSIONIT.....	26
16. LIKUIDIMI VULLNETAR I SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	27
17. LIKUIDIMI I DETYRUESHËM I SHOQËRISË ADMINISTRUESE	27
18. KOMISIONE/TARIFA TË VAZHDUESHME QË PAGUHEN NGA FONDI.....	27
18.1 KOMISIONE/ TARIFA QË PAGUHEN NGA ANËTARI	28
19. DEPOZITARI.....	29
19.1 Funksionet e Depozitarit janë si më poshtë:	29
19.2 Përgjegjësia e depozitarit.....	30
19.3 Konflikti i interesit.....	31
19.4 Delegimi i funksioneve të depozitarit në lidhje me investimet në monedhë të huaj.....	32
20. EMRI DHE SELIA E AUDITUESIT TË JASHTËM	32
21. PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	32
22. DELEGIMI I FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	35
23. NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË PROSPEKT.....	37
24. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE.....	37
ANEKSI 1 - PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORE.....	38
ANEKSI 2 - SHEMAJ ILUSTRATIVË TË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT.....	41

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

“CREDINS INVEST” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK, me NUIS K52311009R, data e themelimit 31/10/2005, data e regjistrimit në QKB 31/10/2005, licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me licencën nr. 3, me Vendimin nr. 156, datë 23/11/2011, me Vendimin nr. 85, datë 30/05/2016, si dhe me Vendimin nr. 207, datë 29.12.2020, me seli në adresën: Rruga “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Estela Koçi, Administratore e Përgjithshme.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj bazuar në ligjin 76/2023, datë 21.09.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe ligjit 56/02020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive, si dhe aktet nënligjore të dala nën zbatim të tyre.

1.1 OBJEKTI I AKTIVITETIT

Shoqëria “Credins Invest” sh.a., (në vijim Shoqëria Administruese) ka si objekt të aktivitetit të saj:

- Fonde Pensioni: Veprimtarinë e mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensionit privat si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, bazuar në licencën nr. 3, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, datë 23.11.2011.
- Fonde Investimi: Veprimtarinë e administrimit të fondeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën me nr. 3, datë 30.05.2016, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- Fonde Investimi Alternative: Veprimtarinë e administrimit të fondeve të investimeve alternative, mbështetur në licencën me nr. 3, datë 30.05.2016, si dhe Vendimin nr. 207, datë 29.12.2020, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

1.2 FONDET NËN ADMINISTRIMIN E SHOQËRISË CREDINS INVEST SH.A.

Shoqëria administruese aktualisht ka nën administrim:

- Fondi i Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Credins Pension”**
Miratuar me Vendimin nr. 173 i Bordit të AMF, datë 13.12.2011, dhe filloi aktivitetin më 1 Janar 2012. Fondi ka një horizont investimi afatgjatë dhe vlera neto e aktiveve të fondit më 31 Dhjetor 2025 është: 3,019,562,364.01 Lekë.
Miratuar me Vendimin nr. 93 të Bordit të AMF, datë 30.06.2025, dhe filloi ushtrimin e aktivitetit të tij më 01.08.2025. Fondi ka një horizont investimi afatgjatë, dhe vlera neto e aktiveve të fondit më 31 Dhjetor 2025 është: 14,047,483.27 Lekë.
- Fondin e Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension”**
Themeluar me Vendimin nr. 86, datë 30.05.2016 nga Bordi i AMF. Fondi është Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, krijuar për një afat të pacaktuar. Fondi ka filluar veprimtarinë e tij më 01.07.2016. Më 31 Dhjetor 2025 vlera neto e aktiveve të fondit është: 951,855,825.44 Lekë.
Themeluar me Vendimin nr. 94, datë 30.06.2025 nga Bordi i AMF. Fondi është Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, krijuar për një afat të pacaktuar. Fondi ka filluar veprimtarinë e tij më 15.09.2025. Më 31 Dhjetor 2025 vlera neto e aktiveve të fondit është: 509,925.58Euro ose 49,345,498.76Lekë.
- Fondi i Investimit “Credins Premium”**
- Fondi i Investimit “Credins Dynamic”**

3. **Fondi i Investimit Alternativ “Sea Land Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK** Regjistruar me Vendimin nr. 57, datë 26.03.2021, nga Bordi i AMF. Fondi është një fond investimesh alternative në formën e shoqërisë komandite. Fondi është me afat të papërcaktuar dhe i ofrohet vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar. Aktivët e Fondit janë kontribute në natyrë dhe në para. Më 31 Dhjetor 2025 vlera neto e aktiveve të fondit është: 3,531,016,747 Lekë.
4. **Fondi i Investimit Alternativ “Green View Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK** Regjistruar me Vendimin nr. 241, datë 29.12.2021, nga Bordi i AMF. Fondi është një fond investimesh alternative në formën e shoqërisë komandite. Fondi është me afat të papërcaktuar dhe i ofrohet vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar. Aktivët e Fondit janë kontribute në natyrë dhe në para. Më 31 Dhjetor 2025 vlera neto e aktiveve të fondit është: 3,557,966,870 Lekë.
5. **“Credins Optimal” - Fond Investimi Alternativ,** Regjistruar me Vendimin nr. 127, 31/07/2024, nga Bordi i AMF. Fondi është një fond investimesh alternative, me afat të papërcaktuar dhe i ofrohet vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar. Aktivët e Fondit janë kontribute në para. Më 31 Dhjetor 2025 vlera neto e aktiveve të fondit është: 5,480,956.06 Euro ose 530,392,117.63Lekë.
6. **“Credins Global Bonds” - Fond Investimi Alternativ,** Regjistruar me Vendimin nr. 194, 01/11/2024, nga Bordi i AMF. Fondi është një fond investimesh alternative, me afat të papërcaktuar dhe i ofrohet vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar. Aktivët e Fondit janë kontribute në para.

Fondi i Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” funksionon bazuar në ligjin nr. 76/2023”, datë 21.09.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, si dhe aktet nënligjore, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Kërkesat e ligjit dhe rregulloreve përbëjnë një pjesë integrale të Prospektit.

Në të gjitha rastet që kërkohen nga ligji, ndryshimet e rëndësishme në prospekt do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (me adresë Rruga “Dora D’Istria”, Nr.10 P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri) ushtron mbikëqyrjen mbi aktivitetet e Shoqërisë Administruese të Fondit dhe Depozitarit.

Prospekti, raportet financiare të ndërmjetme, raporti vjetor i audituar ose botime të tjera të publikuara nga Shoqëria Administruese, do të vihen në dispozicion të anëtarëve pa pagesë, pranë zyrave qendrore të Shoqërisë Administruese, në adresën Rr. “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë, pas një kërkesë me shkrim, në formë fizike, ose nëpërmjet postës elektronike dhe në adresën zyrtare të internetit të Shoqërisë www.credinsinvest.com.

Prospekti i Fondit do të jetë i disponueshëm edhe në degët e Bankës Credins.

Të gjitha informacionet e mësipërme, së bashku me çmimin e kuotës dhe vlerën neto të aktiveve për kuotë, publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese.

1.3 DETAJE TË PËRGJITHSHME TË FONDIT:

FORMA LIGJORE	Fondi i pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” është një grup i veçuar aktivesh, pa personalitet juridik, i krijuar me qëllim mbledhjen e kontributeve në para në llogaritë personale të anëtarëve të fondit dhe investimit të këtyre fondeve për rritjen e vlerës së aktiveve të fondit të pensionit. Fondi i pensionit me pjesëmarrje të hapur zotërohet bashkërisht nga anëtarët e tij, ku pronësia individuale përfaqësohet nga numri i kuotave në fondin e pensionit. Anëtar i këtij fondi mund të jetë çdo individ, përfshirë punëmarrësit e punëdhënësit, i cili zgjedh të kontribuojë në fondin e krijuar nga shoqëria administruese, pa krijuar një fond pensioni me pjesëmarrje të mbyllur.
SHOQËRIA ADMINISTRUESE	Credins Invest sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK
THEMELIMI DHE REGJISTRIMI	Themeluar dhe Regjistruar pranë QKB në datë 31.10.2005 me NUIS K52311009R
SELIA E REGJISTRUAR E SHOQËRISË ADMINISTRUESE	Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri
DATA E THEMELIMIT TË FONDIT	Vendimi nr. 93 i Bordit të AMF, datë 30.06.2025.
ÇMIMI FILLESTAR I KUOTËS	1000 LEK
PROSPEKTI I PARË	Korrik 2025
DATA E FILLIMIT TË VEPRIMTARISE SË FONDIT:	1 Gusht 2025
KONTRIBUTET NË FOND	Pagesat në formë kontributi të bëra në llogarinë personale të anëtarit si dhe aktivet e transferuara në fond, do të shndërrohen në kuota pensioni në ditën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit me çmimin e kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës. Shoqëria administruese është përgjegjëse për shndërrimin e kontributeve në kuota pensioni. Për qëllime vlerësimi, çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në aktivet e fondit të pensionit. Vlera totale e kuotave në fondin e pensionit është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të fondit të pensionit.
VITI FINANCIAR I FONDIT	Fillon më 01 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor
DEPOZITARI	Banka Amerikane e Investimeve sh.a.
NUMRI I LICENCËS SË DEPOZITARIT NGA AMF	Nr. 5 dt. 03.07.2017 (pa afat)
WEBSITE	www.credinsinvest.com

1.4 TË DHËNA KRYESORE TË FONDIT

Në datë 31 Dhjetor 2025, performanca e fondit që prej fillimit të aktivitetit në datë 1 gusht 2025, është 1.52%.

Vlera Neto e Aktiveve	14,047,483.27 Lek
Çmimi i kuotës	1,015.2190 Lek
Numri i anëtarëve	144
Kthimi neto nga investimi (01.08.2025-31.12.2025) *	1.52%

Informacionin mbi të gjitha tarifat dhe komisionet që janë mbajtur nga aktivet e fondit

Raporti midis total i kostove të administrimit dhe vlerës neto mesatare të aktiveve 01.08.2025-31.12.2025	0.5 %*
---	--------

*Ky raport rezulton për periudhën 5 mujore të aktivitetit të Fondit.

Ky raport llogaritet duke pjesëtuar totalin e kostove vjetore të mbajtura nga aktivet e fondit me Vlerën neto mesatare të Aktiveve të fondit. **Niveli maksimal i kostove vjetore të administrimit të mbajtura nuk mund të tejkalojë maksimumin 1.5%.

Shpërndarja e aktiveve të Fondit

Shpërndarja e aktiveve	Monedha Lek	%Aktiveve
Obligacione të Qeverisë shqiptare	11,854,895.83	84.30%
Depozita, mjete monetare dhe ekuivalente	2,207,805.55	15.70%

2. INFORMACION PËR ANËTARËT

Fondi i Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” (në vijim Fondi) i jep mundësi çdo individit ose punëdhënësi, i cili ka për objektiv rritjen e përgjegjësisë sociale duke kontribuar për pensionet e punonjësve të tij, të investojnë në një fond afatgjatë në monedhën LEK me një profil rreziku të ulët. Fondi i adresohet anëtarëve që kanë prioritet sigurinë, kthime afatgjata dhe likuiditetin në moshën e pensionit.

Investimi në Fondi i jep mundësi anëtarëve të diversifikojnë të ardhurat e tyre në moshën e pensionit, dhe të përfitojnë nga riinvestimi i fitimeve të gjeneruara nga kontributet e tyre, sipas Politikës së investimit të Fondit.

Për shkak të natyrës afatgjatë të Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund”, anëtarët e Fondit duhet të jenë të ndërgjegjshëm që tërheqjet nga fondi përpara limiteve ligjore të moshës janë subjekt i penaliteteve mbi shumën e tërheqjes, të cilat llogariten në raport me kohëzgjatjen e anëtarit në Fond. Informacion më i detajuar jepet në seksionin 11.3 “Tërheqja e parakohshme” të Prospektit.

Për çdo ankesë jeni të lutur ta dërgoni me shkrim në adresën zyrtare postare të Shoqërisë “Credins Invest” sh.a., ose duke plotësuar online në faqen zyrtare të shoqërisë, formën në rubrikën “Sugjerime dhe Ankesa”, në adresën elektronike: ankesa@credinsinvest.net. Ankesat do të shqyrtohen nga strukturat përkatëse dhe ju do të merrni përgjigje brenda 20 ditëve pune pas pranimit të ankesës.

3. ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË INVESTIMIT

Politika e investimit e Fondit të Pensionit hartohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Portofolit dhe pas rishikimit

nga Komiteti i Investimeve, miratohet nga Këshilli i Administrimit dhe është pjesë e këtij Prospekti. Drejtorja e Menaxhimit të Portofolit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut është përgjegjëse për zbatimin e Politikës së Investimeve dhe së bashku raportojnë periodikisht pranë Komitetit të Investimeve. Politika e investimit është objekt rishikimi nga Shoqëria Administruese. Ndryshimet e rëndësishme në politikën e investimit kanë të bëjnë me:

- 1) ndryshimin e objektivave të investimit të fondit dhe rreziqeve të lidhura me investimet e parashikuara të fondit;
- 2) ndryshimin e profilit të rrezikut të fondit të pensionit ose aftësisë mbajtëse të rrezikut.

Këto ndryshime janë objekt miratimi nga Këshilli i Administrimit dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Shoqëria informon Anëtarët e Fondit për çdo ndryshim të rëndësishëm, brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së miratimit nga Autoriteti, nëpërmjet postës elektronike ose me postë normale. Çdo ndryshim i rëndësishëm në politikën e investimit do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese.

3.1 PROFILI I INVESTIMIT TË FONDIT

Duke u nisur nga fakti që detyrimet e Fondit janë afatgjata, prirja e profilit të investimit do të jetë afatgjatë, si më poshtë:

Horizonti i Investimit:	Afatgjatë
Niveli i Tolerancës ndaj Rrezikut të Investimit:	Konservative
Miksi i Portofolit/Preferenca e Investimit	Kthimi optimal

Objektivi i Investimit:

Fondi synon optimizimin e normës së kthimit duke minimizuar rrezikun, ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe likuiditetit për të siguruar të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës së pensionit. E ardhura totale e ndjekur nga Fondi përbëhet nga të ardhurat nga interesat dhe fitimi / humbja nga rivlerësimi kapitalit. Karakteristikat e Fondit në radhë prioriteti janë si më poshtë:

Siguria – investimi i aktiveve të Fondit kryesisht në instrumenta me kredibilitet të lartë, siç janë titujt qeveritare dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare;

Likuiditeti - ruajtja e një niveli të mjaftueshëm likuiditeti në monedhën LEK për të përmbushur në kohë të gjitha detyrimet e pensioneve.

Kthimi nga investimi – portofoli i investimeve do të ndërtohet me synimin e maksimizimit të kthimit të kushtëzuar nga kufijtë e rrezikut dhe likuiditetit.

Diversifikimi i investimeve – portofoli i investimeve do përbehet nga lloje të ndryshme aktivesh të tregtuara në vende dhe tregje të ndryshme të specifikuar në politikën e investimit, me qëllim diversifikimin e rrezikut dhe kthimit që mbartin aktivet në të cilat Fondi investon.

Strategjia e Investimit:

Mjetet do të investohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 76/2023, datë 21.09.2023, dhe të politikës së investimeve të miratuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë "Credins Invest" sh.a., e cila detajohet në vijim, gjithmonë duke konsideruar interesin me të mirë të anëtarëve. Të gjitha investimet do të kryhen duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme. Fondi do të investojë kryesisht:

- në obligacione afatgjatë të garantuara nga shtetit shqiptar;
- në obligacione afatgjatë të emetuara nga qeveritë e shteteve anëtare të BE-së dhe OECD-së ;
- në obligacione të institucioneve financiare ndërkombëtare (supranational) si Banka Botërore, Banka Qëndrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve.

Politika e Investimit

Politika e Investimeve do të marrë parasysh një numër kriteresh, siç vijojnë:

- Një politikë e matur dhe konservatore investimi në përputhje me limitet ligjore dhe rrezikun e Fondit, për të ndërtuar marrëdhënie afatgjata besimi me anëtarët/kontribuesit.
- Nevojën për të diversifikuar fondet e akumuluar në mënyrë efektive. Kjo nënkupton që Fondi i Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” do të investojë në lloje të ndryshme aktivesh, dhe do ta shpërndajë rrezikun ndërmjet llojeve;
- Nevojën për të mbajtur sa më të ulëta kostot operacionale, pa e kompromentuar cilësinë e shërbimeve ndaj anëtarëve/kontribuesve.

Fondi do të menaxhohet në mënyrë semi-aktive dhe aktive nga Shoqëria, në varësi të llojeve të aktiveve ku Fondi do investojë, nëpërmjet përdorimit të analizave statistikore dhe sasiore, duke ndërtuar parashikime të normës së kthimit përkundrejt nivelit të rrezikut të aktiveve përbërëse. Strategjia e përzgjedhjes së aktiveve është një proces sistematik dhe dinamik me mekanizma kontrolli dhe balancimi.

Aktivet e Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” do të investohen duke synuar një alokim të balancuar ndërmjet llojeve të ndryshme të investimeve, për të realizuar objektivat e kthimit në përputhje me limitet e rrezikut.

Komiteti i Investimeve përveç të tjerash do të kryejë:

- Shqyrtimin e Politikës së Investimeve në fuqi dhe të çdo propozimi për ndryshimin e saj.
- Vlerësimin e alokimit aktual të aktiveve të Fondit dhe të çdo propozimi për ndryshim.
- Monitorimin e investimeve dhe të çdo propozimi për të rritur ose zvogëluar peshat në këto investime.
- Identifikimin e propozimeve të reja për investime dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit Administrues për miratim.

3.2 ALOKIMI STRATEGJIK I AKTIVEVE

Në bazë të Ligjin Nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, dhe propozimit të Komitetit të Investimeve, Këshilli i Administrimit ka vendosur Alokimin Strategjik të aktiveve të Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund”, sipas tabelës më poshtë:

Kategoritë e investimeve	MIN - MAX	Alokimi i Synuar
Depozita, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1% - 15%	5%
Bono thesari dhe obligacione të emetuara ose të garantuara nga Qeveria e RSH	30% - 99%	65%
Tituj borxhi të emetuara nga bankat dhe institucionet financiare jo-banka, jo të tregtuara në tregje të rregulluara	0%-5%	5%
Bono thesari dhe obligacione të shteteve anëtare të OECD ose të BE-së	0% - 50%	10%

Bono thesari dhe obligacione të emetuara ose të garantuara nga Banka Qëndrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve dhe Banka Botërore	0% - 30%	5%
Obligacione Korporative të tregtuara në treg të rregulluar në shtete anëtare OECD-së dhe të BE-së	0% - 30%	3%
Aksione dhe Kuota të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike	0% - 30%	7%

Shoqëria Administruese do të synojë të respektojë objektivin e përcaktuar për alokimin strategjik. Alokimi i synuar nuk nënkupton një detyrim nga ana e fondit për të investuar sipas shpërndarjes të përcaktuar në tabelë. Komiteti i Investimeve do të gjykojë sipas rastit dhe kushteve të tregut dhe mund të devijojë nga alokimi i synuar. Gjithashtu, Shoqëria ka fleksibilitet për të bërë ndërhyrje afatshkurtra në alokim për të përfituar nga mundësitë që ofron tregu, nëse kjo do jetë në përfitimin e anëtarëve të Fondit, dhe në përputhje me objektivat e Fondit.

Kufizimet “MIN-MAX” përbëjnë kufijtë minimalë dhe maksimalë ku mund të devijojë alokimi i aktiveve nga alokimi i synuar. Shoqëria mund të zbatojë dhe strategji më fleksibël të alokimit për periudha të caktuara, në varësi të luhatshmerisë në tregun financiar dhe flukseve hyrëse-dalëse në Fond.

Në çdo rast alokimi i investimeve do të sigurojë respektimin e limiteve të vendosura në ligjin Nr. 76/2023, datë 21.09.2023 “Për fondet e pensionit privat”, si dhe në rregulloret përkatëse të miratuara nga AMF.

Investimet e Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund”

Investimet e aktiveve të Fondit do të kryhen në instrumentet financiare sipas tabelës së alokimit strategjik në monedhën lek dhe monedha të tjera përmes llogarisë së Fondit.

Titujt e borxhit qeveritar

Për të arritur objektivin e investimit, Fondi ka për objektiv kryesor të investojë përqindjen më të lartë të aktiveve në tituj të transferueshëm dhe tituj borxhi të emetuara ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, si dhe në bono dhe obligacione të emetuara nga qeveritë e shteteve anëtare të OECD-së ose të BE-së. E ardhura nga interesi zë pjesën më të madhe të së ardhurës totale nga këto lloje aktivesh, duke konsideruar luhatshmërinë relativisht më të ulët të vlerës së tregut të obligacioneve qeveritare.

Titujt e borxhit të institucioneve financiare ndërkombëtare

Për arsye diversifikimi të kthimit dhe rrezikut, Fondi synon të investojë një pjesë të aktiveve në instrumente borxhi të emetuara dhe garantuara nga institucione financiare ndërkombëtare si Banka Qëndrore Europiane, Banka e Investimeve dhe Banka Botërore të tregtuara në tregje të rregulluara.

Titujt e borxhit korporativ

Nevoja për rritjen e kthimeve të Fondit kërkon një politikë investimi, e cila e alokon një pjesë të arsyeshme në instrumente për të cilat pritet kthim i lartë, por edhe luhatshmëri e lartë, të tilla si tituj të borxhit korporativ. Duke konsideruar horizontin afatgjatë të Fondit dhe sigurinë e investimeve, Komiteti i Investimeve është i ndërgjegjshëm për rreziqet më të larta që mbart ky lloj aktiv, dhe për të balancuar portofolin, alokimi i synuar në këtë kategori aktivesh është relativisht i ulët dhe do të kombinohet me një alokim më të madh në instrumente me luhatshmëri më të ulët dhe pritshmëri për kthime më stabil.

Për identifikimin e investimeve në tituj të borxhit korporativ do të kryhen analiza të sektorëve industrialë ku operojnë korporatat e përzgjedhura dhe të elementëve thelbësorë të të dhënave financiare, sipas një

metodologjie të përcaktuar.

Obligacione të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në përputhje me specifikimet dhe kufizimet ligjore dhe alokimin e lejuar, Fondi mund të investojë edhe në “Sustainable Bonds” ose Obligacione të Zhvillimit të Qëndrueshëm – instrumente të borxhit të emetura nga qeveri ose entitete të cilat financojnë projekte në mbështetje të faktorëve ESG (mjedisor, social dhe qeverisjes së mirë). Sustainable Bonds mund të jenë të garantuara nga shteti shqiptar, shtet anëtar i OECD-së ose mund jenë të emetuara nga institucionet financiare ndërkombëtare apo korporata.

Tituj borxhi jo të tregtuar në tregje të rregulluara

Duke konsideruar horizontin afatgjatë të Fondit, si dhe për të rritur kthimin dhe diversifikimin e portofolit, Fondi do investojë jo më shumë se 5% të aktiveve në tituj borxhi korporativ të emetura nga banka ose institucione financiare jo-banka, të cilat nuk janë të tregtuara në tregje të rregulluara. Komiteti i Investimeve është i ndërgjegjshëm për rreziqet më të larta që mbart ky lloj aktiviteti, dhe për vendimarrje do kryejë analiza të elementëve thelbësorë të të dhënave financiare përkatëse. Investimet në këtë klasë aktiviteti, Komiteti i Investimeve do ti propozojë në Këshillin Administrues, i cili ndërmerr vendimin final për investim.

Kuotat e SIK

Me qëllim të diversifikimit të portofolit dhe menaxhimit të rrezikut, Fondi mund të investojë deri në 30% të aktiveve në aksione dhe kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike. Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të cilat investojnë në obligacione, përzgjedhja e tyre do të bëhet duke marrë parasysh performancën e fondit, vlerësimin/renditjen e aktiveve që ka investuar fondi, eksperiencën e menaxherëve të fondit si edhe procesin e menaxhimit të rrezikut. Këto sipërmarrje mund të jenë ose jo fonde të tregtuara në bursë. Shoqëria do investojë vetëm në fonde të huaja ku tarifa e administrimit nuk kalon 1%. Anëtarët e Fondit duhet të mbajnë në konsideratë që investimi në këtë lloj aktiviteti mund të ketë luhatshmëri në varësi të çmimit të kuotës së fondeve në përputhje me profilin e tyre të rrezikut. Investimet konkrete në kuota të SIK dhe kostot përkatëse së bashku me parametrat e tjerë të instrumentave specifikë do të publikohen rregullisht në raportet periodike mujore dhe 3-mujore të Fondit.

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre

Me qëllim administrimit të likuiditetit afatshkurtër dhe plotësimit ligjor të çdo detyrimi ndaj anëtarëve/kontribuesve, një pjesë e aktiveve të Fondit do të mbahen në formën e mjeteve monetare dhe depozitave.

Vendimarrja e investimeve

Komiteti i Investimeve është përgjegjës për menaxhimin e procesit të investimit. Komiteti i Investimeve ndërton një portofol duke marrë vendime për investime që përkojnë me objektivat, kufizimet, vlerësimet e tregut të kapitalit, dhe alokimin e aktiveve, monitoron objektivat e investimit të fondit duke respektuar limitet e alokimit të aktiveve, monitoron performancën dhe shpenzimet e fondit. Komiteti vendos komunikim të vazhdueshëm me Këshillin e Administrimit, anëtarët e fondit, dhe siguron materiale edukuese për anëtarët, rekomandon procedura operacionale që forcojnë administrimin e fondit dhe përzgjedh, monitoron dhe nëse lind nevoja rekomandon zëvendësimin e Depozitarit.

Vendimet e Komitetit të investimeve do ekzekutohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Portofolit, të cilat më pas miratohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Komiteti i Investimeve do të veprojë në interesin më të mirë të anëtarëve të Fondit kur ekzekuton vendime tregtimi për administrimin e Fondit. Në këtë kuadër, Shoqëria do të ndërmarrë çdo veprim nën autoritetin e saj për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për Fondin.

3.3 KUFIZIMET E INVESTIMIT

Shoqëria Administruese nuk investon aktivet e Fondit në klasat e mëposhtme :

1. Metale të çmuara apo ekspozimin ndaj bursave të mallrave të tjerë;
2. Aktive fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si antika, punime arti, mjete motorike etj;
3. Instrumenta financiare derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit, normave të interesit apo nga rreziqe të ngjashme;
4. Tituj ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara nga:
 - a) Shoqëria administruese ose çdo aksionar i Shoqërisë Administruese;
 - b) Depozitari i Fondit;
 - c) Çdo person, palë e lidhur me entitetin e radhitur në pikat (a) dhe (b) të këtij paragrafi;
5. Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive që administrohen nga vetë Shoqëria Administruese;

4. ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Kapaciteti për të ndërmarrë rrezik dhe oreksi për rrezik

Në përputhje me ligjin nr. 76/2023, datë 21.09.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, anëtarësimi në fondin e pensionit privat është me kontribute të përcaktuara, ku përfitimet nuk janë të garantura. Si rrjedhojë rrezikun e investimit në fond e mbart anëtari.

Me synimin për të arritur objektivat afatgjatë të Fondit për të paguar detyrimet ndaj anëtarëve, Shoqëria Administruese ndërmerr një nivel rreziku nga investimet dhe të lidhur me detyrimet e Fondit.

Strategjia e investimit e ndërmarrë nga Fondi synon një kthim sa më të lartë , ndërkohë që ruan një qasje të kujdeshme për përmbushjen e detyrimeve të fondit, siç kërkohet nga rregulloret e Fondit. Kjo përfshin një shpërndarje relativisht të lartë në instrumente të sigurta dhe likuide, duke siguruar që niveli i përgjithshëm i rrezikut të mbetet brenda kapacitetit dhe oreksit të rrezikut të miratuar për Fondin.

Megjithëse niveli i rrezikut nuk mund të evitohet plotësisht, është e mundur që të zvogëlohet në nivelin më të ulët të pranuar përmes një procesi aktiv të menaxhimit të rrezikut.

Shoqëria Administruese ka krijuar kornizën e plotë të menaxhimit të rrezikut përmes krijimit të një njësie të pavarur, politikave, procedurave dhe një sistemi efektiv të kontrolleve të brendshme, të cilat bëjnë të mundur identifikimin, matjen dhe kontrollin efektiv të rreziqeve si edhe ekzekutimin e axhustimeve të duhura sadoherë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuar, siç shpjegohet në seksionet në vijim.

4.1 RREGULLAT E MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Shoqëria Administruese në mënyrë që të menaxhojë rrezikun ndaj të cilit është i ekspozuar aktiviteti, ndërmerr masat e mëposhtme:

- Ndarjen e funksioneve të veçanta dhe kontrolleve midis njësisë së administrimit të portofolit, menaxhimit të rrezikut dhe njësisës back-office dhe raportimit financiar.
- Krijimin e një kulture ku kuptimi dhe menaxhimi i rrezikut është përgjegjësia e çdo punonjësi të shoqërisë. Punonjësit e çdo njësie njihen me të gjitha rreziqet ndaj të cilave ekspozohet shoqëria dhe fondi, si dhe të jenë të gatshëm që të sigurohen që çdo rrezik që bie mbi njësitë e tyre po menaxhohet sipas politikave dhe procedurave.

- Promovimin dhe mbështetjen për përvetësimin dhe zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit të rreziqeve.
- Krijimin e njësisë së dedikuar për menaxhimin e rrezikut brenda shoqërisë që të identifikojë e të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme rreziqet, para të cilave janë të ekspozuara aktivet e fondit të pensionit dhe shoqëria administruese, përfshirë, të paktën, rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë, rrezikun operacional, rrezikun e reputacionit, rrezikun ligjor dhe rrezikun e agjencisë. Kjo njësi është përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimeve të shoqërisë administruese dhe administrimit nga ana e saj të fondit të pensionit dhe të japë udhëzime të përditshme, për të siguruar se shoqëria administruese, në funksionet e veta dhe në rolin e administrimit të fondit të pensionit vepron brenda limiteve të rrezikut, të vendosura nga Këshilli i Administrimit dhe të shprehura në kontratën e fondit të pensionit dhe në prospekt.
- Politika e menaxhimit të rrezikut udhëhiqet nga natyra e fondeve dhe tolerancës për rreziktë, përcaktuar në objektivat e investimit të fondit.
- Metodologjitë e vlerësimit të rrezikut mbështeten në praktikat më të mira, si dhe në ligjet, rregulloret dhe standardet kontabël ndërkombëtare.
- Përgjegjësit e proceseve/drejtuesit e njësisë, ose stafi tjetër i përshtatshëm i shoqërisë, kryejnë edhe vetëvlerësime dhe analiza të rreziqeve operationale që kanë të bëjnë me linjat e tyre të biznesit, të mbështetur nga njësisë e rrezikut.
- Politika e rrezikut është ndërtuar mbi një qëndrim gjithëpërfshirës, duke konsideruar jo vetëm rrezikun e aktiveve të fondit, por të gjithë risqet që hasen nga individët gjatë planifikimit për pension.
- Vendosja dhe monitorimi i kufijve për ekspozimet në rrezik gjatë aktivitetit dhe transaksioneve të kryera.
- Përbushja e nevojave për të siguruar buxhetin e nevojshëm për burimet e strukturave dhe sistemeve të menaxhimit të rreziqeve.
- Krijimi i një emri të mirë dhe besimit tek anëtarët e fondit, në lidhje me menaxhimin sa më të mirë të fondeve në përputhje me të gjitha rregullat dhe ligjet, dhe duke u bazuar në praktikat më të mira.
- Raportimi dhe përputhshmëria e veprimtarisë me rregulloret dhe kërkesat e Autoritetit Mbikëqyrës dhe institucioneve të tjera.

Shoqëria ka përcaktuar në politikat dhe procedurat e brendshme metodat matjes, monitorimit dhe raportitmi të treguesve kryesorë të rrezikut. Në vijim detajohen rreziqet kryesore ndaj të cilave ekspozohet Fondi “Master Pension Fund” dhe niveli i tyre i ndikimit.

Rreziqe	Niveli
Rreziku i Tregut	i Mesëm
Rreziku i Kredisë	i Ulët
Rreziku i Likuiditetit	i Ulët
Rreziku i Agjencisë	i Ulët
Rreziku i Operacional	i Mesëm
Rreziku i Përputhshmërisë	i Ulët
Rreziku i Inflacionit	i Mesëm

4.2 IDENTIFIKIMI I RREZIKUT

Një menaxhim rreziku efektiv nënkupton ndarjen e ekspozimeve të rrezikut në kategori specifike që reflektojnë karakteristikat e tyre dalluese.

4.2.1 RREZIQE TË LIDHURA ME INVESTIMIN

Megjithëse lista nuk është ezauruese, shumë nga ekspozimet e portofolit përbëhen nga: rreziku i tregut

(rreziku nga normat e interesit, rreziku nga kurset e këmbimit), rreziku i kreditit, rreziku i likuiditetit, rreziku operacional, etj., të cilat janë të shpjguara si më poshtë:

- **Rreziku i Tregut**

Rreziku i tregut përbëhet nga: rreziku i normave të interesit dhe rreziku i luhatjes së kurseve të këmbimit. Rritja e normave të interesit sjell zvogëlimin e vlerës së tregut të aktiveve të përbëra nga obligacionet dhe bonot. Nga ana tjetër një ambient me norma të ulëta interesi përbën një sfidë për menaxherin e portofolit, pasi duhet të realizojë një normë kthimi të kushtëzuar nga detyrimet e fondit.

Në rastin e një shembulli të ndryshimit të normave të interesit në tregun vendas me rritje me 1%, një obligacion 100 lekë me kohëzgjatje 3 vite, nëse mbahet në portofolin e vlefshëm për shitje, mund të ketë përparësi një rënie të vlerës së tregut në rast të shitjes para kohe të tij, me rreth 3% ndaj total vlerës së obligacionit.

- **Rreziku i kursit të këmbimit**

Fondi e ka të lejuar dhe mund të investojë në lloje aktivesh të denominuara në monedhë të huaj krahas investimit në monedhën vendase. Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku i humbjes së vlerës së aktiveve të Fondit si rezultat i një ndryshimi në vlerën e një monedhe kundrejt monedhës së vëndit LEK. Duke qënë që Fondi mund të ketë investime në disa lloje të aktiveve në monedhën të huaj, këto aktive mund të ekspozohen ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit të këtyre monedhave ndaj monedhës LEK. Një forcim i monedhës vendase, zvogëlon vlerën e aktiveve të denominuara në monedhën të huaj duke sjellë luhatje negative në vlerën e kuotës dhe uljen e normës së kthimit të Fondit.

- **Rreziku i Kredisë**

Një apo disa emetues të titujve të mbajtur në portofol nga Fondi mund të dështojnë në pagesën e detyrimeve të interesit apo principalit. Gjithashtu, përkeqësimi i cilësisë së kreditit të titujve sjell përkeqësime të likuiditetit dhe zvogëlim të Vlerës Neto të Aktiveve. Rreziku i kreditit të titujve të borxhit vlerësohet nga Agjensitë e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit. Ky vlerësim reflekton aftësinë paguese të emëtuesit, si edhe shërben si një bazë krahasuese për aktivet të cilat kanë një vlerësim më të lartë në raport me aktivet të cilat kanë një vlerësim më të ulët. Një ulje në vlerësim nga një notë më e lartë në një notë më të ulët nënkupton një rritje të rrezikut të kreditit dhe mund të ndikonte në uljen e çmimit të titullit të borxhit në portofolin e fondit. Fondi krahas investimit në tituj të Qeverisë Shqiptare të cilët vlerësohen me rrezik shumë të ulët, mund të investojë edhe në tituj të emetuar ose të garantuar nga Qeveritë e vendeve të BE-së ose Bankat e tyre Qendrore me vlerësim krediti më të lartë se A- sipas S&P ose ekuivalenti sipas Moody (A3) të cilët klasifikohen si tituj me vlerësim “Investment grade” me nivel mesatar rreziku të kreditit.

Fondi mund të ketë investime të aktiveve edhe në tituj të institucioneve financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, Banka Qendrore Europiane dhe Banka Europiane e Investimeve, të cilat kanë një vlerësim shumë të lartë krediti (AAA ose ekuivalenti) dhe kategorizohen si investime të sigurta dhe me nivel shumë të ulët të rrezikut të kreditit.

Ndërkohë investimi në obligacionet korporative të tregtuara në tregje të rregulluara të BE-së do të kryhet pas analizave sasiore dhe cilësore nga manaxhimi i rrezikut dhe i portofolit me qëllim vlerësimin e kapacitetit financiar dhe rrezikut të kreditit të emetuesit. Gjithsesi, në çdo rast investimi do të kryhet në tituj të emetuar nga institucione me vlerësim krediti në nivelin A- ose më lart sipas S&P ose ekuivalenti sipas Moody (A3), të cilët klasifikohen si tituj me vlerësim “Investment grade” me nivel mesatar risku të kreditit.

Rreziku i kreditit është evident edhe në investimet që mund të kryejë Fondi në obligacione të emetuara nga bankat dhe institucionet financiare jo-banka, që nuk janë të tregtuara në tregje të rregulluara. Megjithëse përzgjedhja e këtyre titujve do të kryhet mbështetur në analiza të thelluara nga manaxhimi i rrezikut dhe i portofolit, me qëllim vlerësimin e kapacitetit financiar dhe rrezikut të kreditit të emetuesit. Investimi në këto tituj do të jetë i kufizuar dhe në çdo rast do të miratohet nga Këshilli Administrimit të Shoqërisë përpara investimit.

- **Rreziku i Likuiditetit**

Rreziku i Likuiditetit përbën pamundësinë për të likuiduar një aktiv në kohë apo për ta likuiduar atë me një normë kthimi pa humbje. Në disa raste tregu për një instrument financiar mund të boshatiset i gjithi, duke sjellë pamundësinë për ta tregtuar atë instrument. Gjithashtu, shitja e detyruar e një aktivi për të përmbushur nevojat për likuiditet mund të rezultojë me një normë kthimi me humbje. Kjo si pasojë e marrjes në treg të një çmimi shitje për titullin që mund të jetë më i ulët sesa çmimi që vlerësohet çdo ditë nga shoqëria për portofolin e titujve të klasifikuar si të vlefshëm për shitje, ku diferenca (spread) mes çmimeve paraqet edhe kushtet e tregtueshmërisë dhe likuiditetit të tregut financiar.

Fondi do të ketë një alokim të konsiderueshëm në tituj të Qeverisë Shqiptare tregu i të cilëve konsiderohet jo aktiv dhe si rezultat mund të ketë situata në të cilat mund të jetë i vështirë kthimi në likuiditet i titujve të portofolit ose me kosto të lartë.

• Rreziku i Agjencisë

Rreziku i Agjencisë është dëmi që mund t'i shkaktohet Fondit nga vendimmarrje të qëllimshme të administratorëve të Shoqërisë apo menaxherëve të Fondit, për interesa personale dhe në kundërshtim me interesat e anëtarëve të Fondit. Për parandalimin e këtyre veprimeve, Shoqëria administruese ka hartuar politika e procedura të brendshme dhe ka krijuar mekanizmat e nevojshëm të kontrollit.

• Rreziku i depozitarit dhe nën depozitarit

Funksioni i depozitarit kryhet nga një subjekt i licencuar nga AMF siç shpjegohet në seksionin "DEPOZITARI". Megjithatë, për një arsye apo një tjetër, kjo shoqëri nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ligjore, dhe në këtë rast disa aktivitete të fondit, si për shembull regjistrimi i aktiveve të Fondit apo përlllogaritja e vlerës neto të aktiveve, mund të vonohen. Për shkak të alokimit në tituj të tregtuar në tregje ndërkomëbtare, Fondi do të ketë domosdoshmëri edhe funksionin e nen-depozitarit dhe kujdestarit të titujve të huaj, të cilët mund të gjënden në situata që nuk përmbushin dot detyrimet që rrjedhin nga funksioni i tyre. Megjithëse çdo humbje apo dëmtim që mund të pësojë Fondi nga nën depozitari, i ngarkohet depozitari të Fondit, pasi ky i fundit është njësoj përgjegjës si t'i kryente vetë këto funksione, Fondi mund të ketë vonesa në realizimin e transaksioneve dhe rregjistrimin në kohë të tyre.

• Rreziku i Inflacionit

Rreziku i inflacionit përbën rrezikun që ndryshimet në indeksin e çmimeve në ekonomi mund të japin një ulje të rikthimeve nga investimet nëpërmjet një rënie në fuqinë blerëse të parave të investuara. Në përgjithësi pagesat e obligacioneve ndikohen nga ky rrezik sepse flukset mund të bazohen në norma fikse interesi, dhe një rritje në inflacion zvogëlon fuqinë blerëse të tyre. Duke ndjekur këtë shembull të obligacioneve, nëse një investitor blen një obligacion 10 vjeçar që paguan një normë interesi në 4%, por inflacioni shkon në 6%, me kalimin e çdo viti mbajtësi i obligacionit humbet fuqi blerëse nga flukset hyrëse që realizon.

• Rreziku Politik

Rreziku politik asociohet me ndryshimin në ambientin politik, i cili mund të ketë ndikim negativ në të gjithë bizneset e vendit. Njëkohësisht vlerësimet për një mungesë stabiliteti politik në vend, edhe sipas vlerësimeve të jashtme të agjencive të kreditimit, mund të ndikojnë në rritjen e kostove të borxhit dhe rritje të normave të interesit në treg të cilat ndikojnë në çmimin e aktiveve të Fondit.

• Rreziku u i Ndryshimit të Tatimit

Rreziku i ndryshimeve të regjimit tatimor përbën riskun e mundësisë së mosrealizimit të rikthimeve të pritshme të parashikuara, duke u bazuar në një regjim të caktuar tatimor në kohën e kryerjes së kontributeve në fond dhe regjimit të ri tatimor që mund të jetë në kohën e tërheqjes nga fondi me arritjen e moshës së pensionit. Kështu, si pasojë e ndryshimit të barrës tatimore mbi të ardhurat financiare në Republikën e Shqipërisë nga 15% që është aktualisht, do të mund të ndryshojë edhe rendimenti neto dhe vlera finale e investimit nga fondi në të ardhmen kur të kryhen pagesat e vlefshme për kontribuesit në fondin e pensionit, duke e ekspozuar anëtarin ndaj luhatjes së vlerës neto të kuotave të fondit në të ardhmen.

4.2.2 RREZIQE TË TJERA

Krahas rreziqeve të mësipërme të lidhura me investimin, shoqëria administruese mund të përballet edhe me

rreziqe të tjera të biznesit të cilat mund të sjellin humbje për shoqërinë apo dëmtojnë reputacionin e saj, si përsëmbull rreziku operacional, ligjor, reputacional, dhe rreziku i përputhshmërisë.

- **Rreziku Operacional**

Rreziku operacional përbën rrezikun e humbjeve nga mosfunksionimi i sistemeve të Fondit, nga gabime operacionale të punonjësve të Shoqërisë, nga procedura të brendshme të papërshtatshme, ose nga faktorë të jashtëm dhe që përfshin rreziqe ligjore, të dokumentacionit, të procedurave të marketingut, shlyerjes dhe vlerësimit që zbatohen nga Fondi. Shoqëria Administruese ka përpiluar procedura të brendshme dhe sisteme kontrolli për minimizimin e rrezikut operacional.

- **Rreziku Ligjor**

Rreziku ligjor përbën rrezikun e humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia e Shoqërisë Administruese për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë.

- **Rreziku i Reputacionit**

Rreziku reputacional konsiston në perceptimin e publikut mbi besueshmërinë e Shoqërisë Administruese duke përfshirë ndikimin e ngjarjeve specifike, të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht këtë perceptim. Humbja e reputacionit mund të sjellë humbje në të ardhura dhe ulje të vlerës së aksionerëve.

- **Rreziku i Përputhshmërisë**

Rreziku i përputhshmërisë përbën ekspozimin ndaj mos zbatimit plotësisht të kuadrit ligjor me pasojë humbje materiale që mund të vinë nga penalite ligjore dhe gjopa në rast se Shoqëria Administruese nuk arrin të veprojë në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse që rregullojnë veprimtarinë e Fondit, me anë të politikave të brendshme ose me praktikatat më të mira të tregut.

- **Rreziku i Personelit Kyç**

Performanca e Fondit i detyrohet profesionalizmit dhe aftësive të Këshillit të Administrimit, Komitetit të Investimeve dhe personelit kyç, të cilët mund të ndryshojnë dhe për rrjedhojë kjo mund të ndikojë dhe në performancën e ardhshme të Fondit.

- **Rreziku i Delegimit të funksioneve**

Disa funksione të Fondit, siç detajohen në seksionin 14, janë të deleguara palëve të treta të cilat mund të mos përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Kjo mund të ekspozojë shoqërinë administruese pasi ajo mban përgjegjësinë finale ligjore për funksionet e deleguara.

5. PËRLLOGARITJA E VLERËS NETO TË AKTIVEVE

Shoqëria administruese është përgjegjëse për vlerësimin e aktiveve të Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund” dhe është përgjegjëse për caktimin e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit, duke zbritur të gjitha detyrimet për fondin. Llogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit siguron trajtim të paanshëm të të gjithë anëtarëve të fondit dhe duhet të jetë në interes të të gjithë anëtarëve.

Llogaritja e vlerës neto të aktiveve të Fondit kryhet në përputhje ligjin nr. 76/2023, datë 21.09.2023 “Për fondet e pensionit privat”, si dhe rregulloreve në fuqi miratuar nga AMF. Shoqëria ka hartuar dhe miratuar metodologjinë e vlerësimit të aktiveve të Fondit, e cila bazohet në Ligjin nr.76/2023, rregulloreve në fuqi si edhe në parimet e Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, si dhe e ka konsultuar dhe dakortësuar me Depozitarin.

Vlera neto e aktiveve të Fondit llogaritet me 2 numra decimal (2 numra pas presjes dhjetore), ndërsa vlera e kuotës (ose çmimi i kuotës) dhe numri i kuotave llogaritet me 4 numra decimal (4 numra pas presjes dhjetore).

Depozitari i fondit kontrollon dhe verifikon llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimin e kuotës

në përputhje me metodologjinë e vlerësimit dhe është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes.

Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t-1), rezulton nga diferenca ndërmjet vlerës totale të aktiveve të fondit të pensionit në ditën (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).

Dita t-1, është dita e vlerësimit për të cilën kryhet përlllogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe çmimit të kuotës.

Metodologjia e vlerësimit të aktiveve të Fondit është miratuar nga Shoqëria Administruese dhe nga Depozitari dhe është depozituar në Autoritet. Kjo metodologji detajon mënyrën e vlerësimit të aktiveve të Fondit sipas modelit të biznesit të përcaktuar për Fondin.

Aktivet e blera dhe të mbajtura në një monedhë të huaj, do të llogariten në ekuivalentin në Lekë duke zbatuar normën e kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi në ditën e vlerësimit. Në rastin kur monedha në të cilën janë blerë aktivet nuk është përfshirë në listën e normave të kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, do të përdoren normat mesatare të kursit të këmbimit të kësaj monedhe me euron, marrë nga bankat qendrore përkatëse dhe vlerat e paraqitura në euro, duhet të kthehen në ekuivalentin e tyre në Lekë, duke zbatuar kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi në ditën përkatëse.

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre: Për vlerësimin e llogarisë rrjedhëse që gjeneron interes dhe depozitave me afat, përdoret metoda e kostos së amortizuar, përkatësisht vlera nominale e rritur me interesin e akumuluar. Të ardhurat nga interesi llogariten në bazë ditore dhe pagesa kryhet në datën e maturimit. Baza e llogaritjes është 365 ditë dhe interesi fillon ditën e parë.

Titujt e borxhit të mbajtur deri në maturim, do të llogariten me koston e amortizuar, duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit të realizuar (yield) në momentin e çdo investimi fillestar. Këtu mund të klasifikohen titujt e emtuar nga Qeveria shqiptare dhe/ose bankat dhe institucionet financiare jo banka, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara.

Titujt e borxhit të emtuar nga Qeveria shqiptare të mbajtur për tregtim, do të vlerësohen në baza ditore përmes përdorimit të kurbës së yield-it deri në maturim (yield to maturity), si edhe ditëve të mbetura deri në maturim. Kurba e yield-it do të sintetizohet duke ju referuar yield-eve më të fundit në ankandet primare, si edhe duke përdorur metodën e interpolimit linear.

Titujt e borxhit të emtuara apo të garantuara nga Qeveritë e BE-së ose OECD, nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe korporative sipas alokimit të aktiveve, të tregtuara në tregjet e BE-së apo në tregjet likuide të vendeve anëtare të OECD, vlera e drejtë do të përcaktohet në bazë të çmimit të fundit të ofertës në blerje zyrtarisht e listuar/kuotuar në shtypin financiar.

Në rastet kur në ditën e vlerësimit konstatohet se një ditë më parë “t-1” nuk ka patur tregtim, vlera e instrumentit e nxjerrë nga vlerësimi i ditës “t-2” do të konsiderohet si vlera e drejtë.

Titujt e borxhit në monedhë të huaj do të rivlerësohen në monedhën LEK çdo ditë duke zbatuar normën e kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi. Diferencat e konvertimit do të njihen në Pasqyrën e Fitim Humbjes të Fondit.

Kuotat e SIK: Vlerësimi i aksioneve ose kuotave të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike përfshirë sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, kryhet sipas përcaktimeve më poshtë:

- Çmimin më të fundit në blerje (bid) të aksionit ose kuotës të disponueshëm në kohën e vlerësimit nëse sipërmarrja në fjalë kuotohet me dy çmime (bid/ask), ose çmimin e vetëm nëse sipërmarrja në fjalë është me çmim të vetëm;
- Në rastin kur vlera neto e fondit të investimit nuk është publikuar, ose kur vlera neto e aktiveve për kuotë nuk është në dispozicion për ditën e vlerësimit, vlera e drejtë e kuotës së blerë do të jetë çmimi i kuotës në

ditën e mëparshme të ditës së vlerësimit, pra çmimi më i fundit që është botuar për atë fond investimi nga shoqëria përkatëse e administrimit.

Kuotat e SIK do të rivlerësohen në LEK çdo ditë duke zbatuar normën e kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi. Diferencat e konvertimit do të njihen në Pasqyrën e Fitim Humbjes të Fondit.

6. PERFORMANCA E FONDIT DHE PUBLIKIMI

Shoqëria Administruese përlogarit çdo ditë Vlerën Neto të Aktiveve dhe çmimin e Fondit. Pasi i konfirmon këto të dhëna çdo ditë me Bankën Depozitare, e cila kontrollon dhe verifikon, duke qenë përgjegjëse për saktësinë e llogaritjes, i publikon ato në faqen zyrtare të Shoqërisë.

Në rastet kur faqja zyrtare ka probleme të përkohshme teknike, anëtari mund të informohet me telefon apo pranë zyrës qendrore të “Credins Invest” sh.a..

Pasi fondi të ketë krijuar të dhëna historike, këto do të publikohen në faqen zyrtare, të paraqitura me shifra dhe grafikisht, duke përfshirë edhe strukturën aktuale të aktiveve të Fondit me ndarjen në përqindje sipas tipeve të investimeve.

Çdo anëtar i Fondit pajset me kredencialet (emër përdoruesi dhe fjalëkalim) për të aksesuar online kudo dhe në çdo kohë llogarinë e tij individuale për aktivet përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aktiveve, totalin e ndryshimit të aktiveve për periudhën 12 -muajore, normën e kthimit nga investimi për fondin për periudhën 12-mujore, kthimin nga investimi, që nga fillimi i pjesëmarrjes në fond, datat e kontributeve dhe transferimet e aktiveve të bëra nga ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse në Fond.

6.1 DOKUMENTACIONI I FONDIT DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Shoqëria “Credins Invest” sh.a. publikon dhe rifreskon në mënyrë periodike në faqen e saj zyrtare dokumentacionin e mëposhtëm:

- Prospekti;
- Raporti mujor i performancës së Fondit;
- Raportet 3-mujore financiare;
- Pasqyrat Financiare të Audituar;

Prospekti, Raportet vjetore, mujore dhe çdo informacion shtesë do të vihet në dispozicion të anëtarëve pa pagesë, me kërkesën e tyre pranë zyrave të Shoqërisë Administruese në adresën Rr. “Nikolla Tupe”, Nr.1, Kati 3, Tiranë.

Gjithashtu, dokumentacioni i Fondit është i publikuar dhe në faqen zyrtare të Shoqërisë “Credins Invest” sh.a., përkatësisht www.credinsinvest.com.

7. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

1. Shoqëria Administruese ka detyrimin:
 - a) Të administrojë me efektivitet aktivet e anëtarëve në fond, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e aktiveve të anëtarëve.
 - b) Të krijojë dhe të mbajë regjistrin e kuotave të fondit me saktësi dhe plotësi.
 - c) Të regjistrojë anëtarin në regjistrin e anëtarëve të fondit, të hapë një llogari personale në emër të anëtarit të fondit bazuar në të dhënat e deklaruara nga anëtari në kontratën/deklaratën e anëtarësimit dhe

dokumentit të identifikimit, dhe pas kryerjes së pagesës në llogarinë e fondit të bëjë konvertimin e kësaj të fundit në kuota, ta pajisë anëtarin me kredencialet përkatëse.

- d) Të pajisë anëtarët me kredencialet – Përdorues/Fjalëkalim për të aksesuar llogarinë e tyre në fondin e pensionit privat.
- e) Të jetë transparente ndaj anëtarëve duke i njoftuar dhe informuar anëtarët nëpërmjet postës elektronike ose me postë normale për:

i. Ndryshime të rëndësishme të Prospektit:

- Ndryshimi i objektivave të investimit dhe rreziqeve të lidhura me investimet e parashikuara të Fondit;
- Ndryshimi i profilit të rrezikut të Fondit ose aftësisë mbajtëse të rrezikut;
- Rritja e komisionit të administrimit, komisionit të transferimit, si dhe përfshirja e një komisioni të ri të padeklaruar më parë në prospekt, brenda kufijve të përcaktuar në ligj;

Ndryshimet e mësipërme u njoftohen anëtarëve brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së miratimit nga Autoriteti. Ndryshimet e rëndësishme të prospektit publikohen edhe në faqen zyrtare të shoqërisë.

- ii. Gjendjen e llogarisë, duke dërguar brenda datës 15 Shkurt të çdo viti “Vërtetimin për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit”.
- iii. Të informojë anëtarin për vlerësimin aktual të llogarisë individuale, si dhe ta pajisë me opsionet për mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe t’i japë udhëzime se si mund të zbatohet çdo mënyrë, 3 muaj përpara se anëtari të arrijë moshën për pension, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
- iv. Publikon në faqen zyrtare të internetit çdo ditë çmimin e kuotës së fondeve dhe vlerën neto të aktiveve, pas rakordimit dhe konfirmimit me depozitarin e fondit.
- f) Shoqëria administruese është përgjegjëse për saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të Fondit.
- g) Shoqëria Administruese angazhohet të respektojë konfidencialitetin e llogarisë individuale të çdo anëtari dhe të japë informacion mbi aktivet vetëm tek Anëtarët e Fondit, personat e autorizuar nga Anëtari, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji.
- h) Shoqëria administruese vepron brenda limiteve të rreziqeve të vendosura nga Këshilli i Administrimit.

Aktivitetet e Fondit, që ka nën administrim Shoqëria Administruese, nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimit, si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të shoqërisë administruese, sipas legjislacionit shqiptar dhe as të shlyerjes apo ekzekutimit të pretendimeve kundrejt Shoqërisë Administruese.

8. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT

Anëtari i fondit të pensionit, ka të drejtat e detyrimet e mëposhtme:

- a. Të informohet rregullisht për Fondin (raporte vjetore, tremujore, etj)
- b. Të ketë pronësinë e aktiveve të investuara në Fond;
- c. Të marrë pjesë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
- d. Të përcaktojë masën e kontributit në vlerë absolute ose si përqindje, të ndryshojë këtë shumë, si dhe mënyrën apo frekuencën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes së tij;
- e. Të informohet, mbi vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij të pensionit;
- f. Të informohet mbi të drejtën e tij të pakushtëzuar, për marrjen e pagesës së pensionit nga llogaria e tij e pensionit privat, pas mbushjes së kushteve ligjore për përfitimin e pagesave të fondit të pensionit privat;
- g. Të drejtën e tërheqjes së parakohshme
- h. Të transferojë aktivet e veta nga një fond pensioni në një tjetër fond pensioni;
- i. Të ketë të drejtën që aktivet e Fondit, në rast falimenti të shoqërisë administruese, të jenë objekt i ndarjes;

- j. Të ketë një fond pensioni të trashëgueshëm;
- k. Mosvazhdimi i pagesës së kontributeve nga anëtari:
 - i) nuk nënkupton ndërprerjen e anëtarësimit në fond;
 - ii) nuk nënkupton se anëtari do të penalizohet në rast se në emër dhe për llogari të tij nuk paguhen kontribute.
- l. Anëtari i fondit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit mund të zgjidhë pa penalitete kontratën e anëtarësimit në fond, pa përmendur arsye të veçanta, duke njoftuar me shkrim ose postë elektronike shoqërinë administruese.
- m. Në rastin e përcaktuar në pikën I më sipër, shoqëria administruese i kthen anëtarit vlerën e kontributeve të paguara në llogari, përfshirë kthimin nga investimi, përjashtuar tarifën e administrimit për atë periudhë. Shoqëria administruese bën pagesën brenda 5 ditëve pune nga dita e marrjes së kërkesës me shkrim të anëtarit.
- n. Anëtarët janë përgjegjës për detyrimet përkatëse të Fondit deri në masën e përqindjes së tyre zotëruese në fond. Anëtarët nuk janë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit.
- o. Anëtarët janë përgjegjës të përditësojnë emai-in dhe vendbanimin me adresa të sakta si dhe të dhënat e tyre personale.

9. KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT

Pagesat e kontributeve

Pagesa e kontributeve kryhet në monedhën LEK në mënyrat e mëposhtme:

1. Transfertë nga degët e çdo banke të nivelit të dytë, për në llogarinë e Fondit nr. AL6221011012000000003659837 në LEK, pranë Depozitarit ABI Bank, kundrejt tarifave në fuqi;
2. Autorizim për pagesa automatike periodike;
3. Zbritje e kontributit individual të punonjësit nga paga e individëve dhe kalimit të transfertës nga ana e punëdhënësit për vlerën totale të listës së kontributeve të punëmarrësve dhe punëdhënësit. Bazuar në nenin 20 të Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, kontributi mujor i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni privat, deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi, zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi. Dokumenti justifikues është kontrata individuale që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese në rastin e anëtarësimit individual ose deklarata e pranimit të pjesëmarrjes së punëmarrësit në fondin me pjesëmarrje të hapur të përzgjedhur nga punëdhënësi. Në rastin kur kontributi në fondin e pensionit privat është me burim nga marrëdhënia e punësimit, ai i zbritet të ardhurës personale të tatueshme, përpara përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale nga agjenti i mbajtjes së tatimit në burim
 - a) Vlera e pagesave të kontributeve të punëdhënësve dhe të punëmarrësve të tyre do të jetë në varësi të politikës të miratuar nga punëdhënësi.
 - b) Pagesat e kontributeve të individëve mund të jenë:
 - i. si pagesë e menjëhershme jo më pak se vlera 1.5 milion LEK;
 - ii. kontribut mujor/ vjetor në monedhën Lek, jo më të vogël se maksimumi i zbritshëm fiskal sipas legjislacionit tatimor në fuqi, i cili është deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi;
 - iii. kombinim i dy mënyrave të mësipërme

Kontributet mund të paguhen nga:

- a) Çdo person fizik që është anëtar në Fond ose nga çdo person tjetër jo anëtar, në emër dhe për llogari të anëtarit;

- b) Çdo punëdhënës, i cili pasi ka lidhur kontratën me shoqërinë administruese kontribuon në emër dhe në favor të punëmarrësve të tij, si dhe zbret nga paga bruto kontributet individuale të punëmarrësit

Pagesat në formë kontributi të bëra në llogarinë personale të anëtarit si edhe aktivet e transferuara në Fond do të shndërrohen në kuota pensioni në ditën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit me çmimin e kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës.

Shembull i blerjes së një kuote pensioni në monedhën LEK:

Çmimi i kuotës së pensionit në ditën e kontributit:	1,200.00 LEK/kuotë
Kontributi:	50,000.00 Lekë
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (50,000.00 Lekë /1,200.00 Lekë)	41.6667 kuota
Vlera neto e aktiveve për çdo anëtar kur çmimi kuotës arrin 1,350 Lekë/kuotë.	56,250.45 Lekë

Transaksioni i anëtarit regjistrohet nga ana e Shoqërisë Administruese në llogarinë individuale të anëtarit në regjistrin përkatës të Fondit, e cila mbahet paralelisht edhe pranë Depozitarit. Nëse pas disa kohësh çmimi i kuotës do të rritet nga 1,200.00 Lekë në 1,350.00 Lekë, vlera e aktiveve të anëtarit në Fond që ka kontribuar në monedhën Lekë (pa tarifën e kostos së administrimit) do të jetë 1,350.00 Lekë x 41.6667 kuota = 56,250.45 Lekë.

Ndërprerja e pagesave

Nëse një anëtar në Fond, përkohësisht ose përfundimisht ndërpret pagesën e kontributit, ai/ajo do të vazhdojë të mbetet anëtar në Fond duke ruajtur të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë.

10.TATIMI

10.1 REGJIMI TATIMOR I FONDIT TË PENSIONIT

Në përputhje me ligjin nr. 76/2023, datë 21.09.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, Neni 156, si dhe ligjit Nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar):

1. Kontributi i bërë nga çdo Anëtar në Fond zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi.
2. Kthimi i investimit përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me aktivet e Fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për shoqërinë administruese.
3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër në emër dhe për llogari të Anëtarit të Fondit, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të Anëtarit.
4. Kufiri maksimal mujor, për lehtësitë tatimore, sipas përcaktimit të pikës 1, është deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.
5. Blerja e kuotave të Fondit është shërbim financiar dhe si rrjedhojë është e përjashtuar nga TVSH. Shërbimet e ofruara nga Depozitari për Shoqërinë Administruese dhe Anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe si rrjedhojë janë të përjashtuara nga TVSH.
6. Tërheqja e parakohshme tatóhet me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të tërhequr para kohe, përfshirë kontributet.
7. Blerja e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” nga një shoqëri sigurimi jete, që sjell një produkt me të ardhura të rregullta, periodike, do të trajtohet me të njëjtat lehtësi fiskale si pagesat periodike në formë pensioni të parashikuar në nenin 75 të ligjit 76/2023.

10.2 TRAJTIMI FISKAL I KONTRIBUTEVE TË BËRA NGA PUNËDHËNËSI

Në përputhje me ligjin Nr. 76/2023, datë 21.09.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, Neni 157, si dhe ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), kontributet e bëra nga

punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në fondin e pensionit të zgjedhur nga punëdhënësi, vlerësohen si shpenzim operativ deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës të barabartë me pagën minimale vjetore të miratuar në shkallë vëndi, dhe kjo shumë vlerësohet si shpenzim i njohur për qëllime të tatimit mbi fitimin e punëdhënësit.

10.3 TRAJTIMI FISKAL I PAGESAVE TË MARRA NGA ANËTARI

Në përputhje me ligjin Nr. 76, datë 21.09.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, Neni 158:

1. Pagesat e marra nga anëtari i Fondit në mënyrë periodike mujore taten në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë;
2. Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar të parashikuar, taten në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat personale.

Aktualisht ligji Nr 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar në nenin 20 parashikon:

Pika 7. - Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë periodike mujore taten vetëm për kthimin nga investimi, me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale.

Pika 9. - Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme, përpara afatit të marrjes së tyre në mënyrë periodike mujore, siç parashikohet në ligjin për fondet e pensionit privat, taten me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra, përfshirë kontributet.

Çdo ndryshim ligjor lidhur me trajtimin fiskal, do të reflektohet edhe në prospektin e Fondit.

11. PAGESAT E PENSIONIT PRIVAT

Tërheqja e vlerës neto të aktiveve nga llogaria individuale e Anëtarit mund të bëhet kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara në ligj të shprehura në pikën 11.1 në vijim. Shoqëria Administruese do të ushtrojë edhe veprimtarinë e kryerjes së pagesave të pensionit.

11.1 PAGESA E PENSIONIT

1. Çdo Anëtar i Fondit sipas zgjedhjes ka të drejtë të përfitojë nga pagesa e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij, ose nga pagesa periodike në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlere, kur:
 - a) mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm që zbatohet për atë anëtar;
 - b) 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm;
 - c) kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Pagesa e menjëhershme, sipas përcaktimit në pikën 1, mund të jetë:
 - a) Pagesë e plotë e vlerës neto të aktiveve në llogarinë e anëtarit;
 - b) Pagesë e pjesshme e vlerës neto të aktiveve.
3. Anëtari i Fondit pasi përmbush kushtet e përcaktuara në pikën 1, gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij apo të një pjese të saj në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - a) Pagesa e pensionit përmes shoqërisë së sigurimit të jetës, duke blerë një kontratë të sigurimit të jetës në formë “anuiteti”, të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës, e licencuar nga Autoriteti, siç detajohet në seksionin 11.2 në vijim.
 - b) Pagesa e pensioneve në mënyrë periodike mujore të zgjatura në kohë jo më pak se 2 vjet, pavarësisht vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij. Pagesat periodike mujore do të kryhen mbështetur në një kontratë të veçantë që do të lidhet midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara në pikën 1 më sipër.

- c) Pagesa e pensionit në mënyrë të menjëhershme e vlerës neto të aktiveve, do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës nga anëtari.
4. Anëtari i fondit të pensionit i cili ka ushtruar të drejtën të marrë/dhe ose të përdorë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij të të pensionit, sipas përcaktimeve të pikes 1, nuk mund të vijojë të derdhë kontribute në fond.
 5. Me qëllim përfitimin e pagesës së të gjithë aktiveve të veta në fond, Anëtari i paraqet një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen, specifikisht për rastet që plotësojnë kushtin 1/c më lart..
 6. Komisionet bankare që shoqërojnë pagesat në llogarinë e anëtarit do të paguhen nga vetë anëtari.
 7. Shoqëria administruese e fondit të pensionit i njofton anëtarët 3-muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aktiveve neto në llogarinë e tij të pensionit dhe i informon anëtarët për vlerësimin aktual të llogarisë individuale, për opsionet e mënyrës së pagesës së pensionit si dhe i jep udhëzime se si mund të zbatohet çdo mënyrë e sipërcituar.
 8. Konvertimi i kuotave të anëtarit në para do të kryhet me çmimin e kuotës së ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje të menjëhershme.
 9. Pagesat periodike mujore, në para, të kuotave që gjenden në llogarinë individuale të anëtarit, vlerësohen me çmimin e kuotës të ditës së njohjes së detyrimit të përcaktuar në kontratën për pagesat periodike të nënshkruar mes palëve.
 10. Për pagesat periodike mujore të pensionit privat, Shoqëria Administruese ka detyrimin të dërgojë urdhrin e pagesës, brenda 3 ditëve pune, nga data e njohjes së detyrimit, për ekzekutimin e pagesës.

Në Aneksin 2, në fund të këtij dokumenti, ilustrohen me shembuj skenarë të ndryshëm se si ndikon kohëzgjatja e periudhës së investimit në Fond (e lidhur kjo me moshën e Anëtarit) në kontributin që duhet të derdhë Anëtari në Fond, në mënyrë që të përfitojë një pension të përshtatshëm.

11.2 PAGESA E PENSIONIT PËRMES SHOQËRISË SË SIGURIMIT TË JETËS

Nëse anëtari i Fondit, me plotësimin e kushteve ligjore të pensionit, vendos të blejë një kontratë të sigurimit të jetës në formë “anuiteti” nga një shoqëri sigurimi jete, vlera neto e aktiveve në llogarinë e anëtarit të Fondit do të transferohet te shoqëria e sigurimit të jetës të zgjedhur nga anëtari.

Shoqëria Administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës për kërkesën e anëtarit të Fondit dhe merr një konfirmim për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë “anuiteti”, si dhe transferon vlerën neto të aktiveve të anëtarit, tek shoqëria e sigurimit brenda 15 ditë pune nga data e depozitimit të kërkesës së anëtarit.

Modalitetet e pagesave periodike, koha e fillimit, përfundimit të pagesave, si dhe çështje të tjera të ngjashme do të përcaktohen në kontratën e sigurimit të lidhur ndërmjet anëtarit dhe shoqërisë së sigurimit.

Vlera neto në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, e transferuar te shoqëria e sigurimit të jetës, do të përdoret vetëm për qëllim të blerjes së një kontrate të sigurimit të jetës në formë “anuiteti” të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës.

11.3 TËRHEQJA E PARAKOHSHME

1. Tërheqja e vlerës neto të aktiveve nga llogaria individuale e Fondit përpara plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 11.1/1 quhet tërheqje e parakohshme.
2. Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitete që llogariten në raport me kohën e përmbushur nga anëtari nga çasti i kontributit të tij të parë e deri në çastin e tërheqjes së parakohshme të të gjitha aktiveve nga llogaria e tij individuale në fondin e pensionit konkretisht:
 - a) Për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të, aplikohet 15% penalitet.

- b) Për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon, pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të, aplikohet 10% penalitet.
 - c) Për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon, pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet, përfshirë edhe vitin e 20-të, aplikohet 5% penalitet.
 - d) Për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë, aplikohet 2% penalitet
3. Penaliteti në rastin e tërheqjes së parakohshme llogaritet mbi vlerën neto të aktiveve të kërkuara për tu tërhequr para kohe, pasi është zbritur tatimi sipas rastit në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi të ardhurat në fuqi, në momentin e tërheqjes
 4. Kur anëtari transferon aktivet në një fond tjetër pensioni privat, për efekt të llogaritjes së penaliteteve në rast të tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga fondi i ri, në përlllogaritjen e kohëzgjatjes së anëtarësimit do të përfshihet edhe periudha e anëtarësimit që nga data e derdhjes së kontributit të parë në fondin e parë nga i cili janë transferuar aktivet.
 5. Kur anëtari zgjedh të hapë një llogari tjetër në një fond tjetër pensioni, të administruar nga e njëjta shoqëri ose nga një shoqëri tjetër administruese, për efekt të llogaritjes së penaliteteve në rast të tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga ky fond i ri, kohëzgjatja e anëtarësimit do të llogaritet që nga data e derdhjes së kontributit të parë në këtë fond të ri.
 6. Shoqëria administruese brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së anëtarit, urdhëron depozitarin të kryejë pagesën e aktiveve që do të tërhiqen nga anëtari.
 7. Nuk aplikohet penalitet për sponsorin/punëdhënësin në rastet e tërheqjes së parakohshme të punëmarrësit, brenda periudhës përpara se punëmarrësit t'i lindë e drejta për të përfituar kontributet e derdhura nga punëdhënësi në favor të tij, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vite. Përrjashtimi nga penalitetet është vetëm për pjesën e kontributit të derdhur të sponsorit/punëdhënësit.
 8. Konvertimi i kuotave të anëtarit që do të tërhiqet do të kryhet me çmimin e kuotës së ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje.
 9. Tërheqja e parakohshme tatóhet me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të tërhequr para kohe, përfshirë kontributet.
 10. Në rastin e vdekjes së Anëtarit të Fondit nuk aplikohet penaliteti i tërheqjes së parakohshme.

11.4 PROCEDURA PËR TËRHEQJEN E AKTIVEVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE

1. Në rastin e pagesës së menjëhershme të aktiveve neto të akumuluar në bazë të kërkesës standarde të plotësuar nga anëtari i Fondit, Shoqëria Administruese i paraqet urdhrin Depozitarit brenda 15 ditëve pune, në mënyrë që ai të kryejë pagesën e aktiveve neto të akumuluar në llogarinë individuale të Anëtarit sipas afateve të përcaktuara më sipër.
2. Në rastin e pagesës periodike të vlerës neto të aktiveve të akumuluar, mbështetur në marrëveshjen e nënshkruar midis anëtarit të Fondit dhe Shoqërisë Administruese mbi pagesat periodike, do të kryhet pagesa mujore.

Anëtari i Fondit në mënyrë të pavarur përcakton shumën dhe frekuencat e pagesave periodike të cilat mund të ndryshohen me kërkesën e tij dhe detajohen në marrëveshjen e nënshkruar midis anëtarit dhe Shoqërisë Administruese. Shuma e pagesës periodike përcaktohet si numër kuotash në kontratën e nënshkruar.

11.5 FONDI I PENSIONIT PRIVAT ËSHTË I TRASHËGUESHËM

Fondet në llogarinë personale të një anëtarit të Fondit trashëgoohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon të drejtën e trashëgimisë.

12. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT

Marrëveshja e anëtarësisë në Fond përfundon:

1. Në rastin kur të gjitha aktivet e Anëtarit të Fondit janë transferuar në një tjetër fond pensioni;
2. Në rastin e tërheqjes së parakohshme të të gjitha aktiveve të Anëtarit të Fondit;
3. Në rastin e tërheqjes në mënyrë të menjëhershme të vlerës së plotë të aktiveve në llogarinë e anëtarit ose nëpërmjet kontratës së pagesave periodike, (kur janë plotësuar kushtet), kur të jenë shlyer dhe kuotat e fundit në llogarinë e anëtarit në fondin e pensionit në përputhje me dispozitat e kontratës në fjalë;
4. Në rastin kur anëtari i Fondit ka zgjedhur të marrë pagesën e pensionit nëpërmjet një shoqërie të sigurimit të jetës, anëtarësia e tij në Fond përfundon me kalimin e aktiveve në llogarinë e anëtarit në shoqërinë e sigurimit të jetës, sipas zgjedhjes së anëtarit;
5. Në rastin e vdekjes së Anëtarit të Fondit dhe shlyerjes së aktiveve kundrejt trashëgimtarëve sipas dispozitave ligjore;
6. Përfundimi i anëtarësisë në fond nënkupton mbylljen e llogarisë së anëtarit në fondin e pensionit.
7. Anëtari i fondit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit mund të zgjidhë pa penalitete kontratën e anëtarësimit në fond, pa përmendur arsye të veçanta, duke njoftuar me shkrim ose postë elektronike shoqërinë administruese.

13. REFUZIMI I ANËTARËSISË

- 1) Shoqëria administruese mund të refuzojë lidhjen e kontratës së anëtarësisë nëse:
 - a) ekziston dyshimi se mund të kryhet vepra penale e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;
 - b) ekziston një shkak i ligjshëm ose një vendim gjykate, i cili pengon shoqërinë administruese të pranojë anëtarin në fond.
- 2) Kur shoqëria administruese refuzon lidhjen e kontratës së anëtarësimit në fond, duhet të informojë anëtarin e mundshëm për arsyet e refuzimit, përveçse kur legjislacioni në fuqi nuk e lejon.

14. TRANSFERIMI I AKTIVEVE TË ANËTARIT

1. Anëtari i Fondit ka të drejtë që në çdo kohë të transferojë aktivet e veta nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta shoqëri administruese, ose nga një shoqëri administruese tjetër.
2. Transferimi i aktiveve në një fond tjetër pensioni të administruar nga e njëjta shoqëri administruese nuk shoqërohet me komision transferimi. Në rastin e transferimit të aktiveve të anëtarit në një shoqëri tjetër administruese, shoqëria administruese me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtari për të transferuar aktivet, njofton brenda 5 ditëve pune shoqërinë tjetër administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aktiveve.
3. Shoqëria administruese ekzekuton transferimin e aktiveve në llogari brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së konfirmimit të shoqërisë administruese tjetër.
4. Në rastin e transferimit brenda të njëjtës shoqëri administruese, transferimi ekzekutohet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës së anëtarit për transferimin e aktiveve.
5. Brenda 5 ditëve pune nga dita e transferimit të llogarisë, shoqëria informon anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën totale neto të aktiveve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si edhe detyrimet e zbritura.

6. Transferimi i aktiveve në llogarinë e anëtarit në një fond pensioni të administruar nga një shoqëri tjetër administruese shoqërohet me një komision transferimi nga fondi deri në masën 0.5 % të shumës së transferuar.
7. Konvertimi i kuotave të anëtarit në para do të kryhet me çmimin e kuotës së ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për transferim.
8. Transferimi nuk mund të kryhet nëse detyrimet e Anëtarit ndaj Fondit të mëparshëm nuk janë shlyer.

15. BASHKIMI, NDARJA DHE SHNDËRRIMI I FONDIT TË PENSIONIT

Fondi i pensionit privat mund të ndahet në dy ose më shumë fonde ose mund të bashkohet me dy ose më shumë fonde të tjera me miratimin e Autoritetit.

Ndryshimi i formës së Fondit të pensionit privat nëpërmjet bashkimit, ndarjes ose shndërrimit nuk lejohet nëse dobëson pozitat pozicionin ekonomik të anëtarëve të fondeve ose është në dëm të interesave të anëtarëve.

Bashkimi i fondeve

Bashkimi i fondeve kryhet me transferim të një fondi ekzistues ose nëpërmjet krijimit të një fondi të ri si më poshtë:

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi/disa fondeve të pensionit (fond transferues) që bashkohen i kalojnë një fondi pensioni ekzistues (fond marrës). Anëtarët e fondeve të pensionit, pjesëmarrëse në bashkim, marrin kuotat në fondin marrës dhe fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim prishen;

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi/disa fondeve që bashkohen (fond transferues) i kalojnë një fondi pensioni marrës të krijuar rishtazi, anëtarët në fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në fondin e pensionit marrës dhe fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim prishen.

Pas bashkimit, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit transferues.

Pas bashkimit, vlera totale e të gjitha kuotave, që zotëron anëtari në fondin marrës, duhet të jetë e barasvlershme me vlerën totale të kuotave që anëtari zotëronte në fondin transferues përpara ndryshimit të statusit.

Depozitarët e fondeve që marrin pjesë në procedurën e bashkimit, në mënyrë të pavarur përgatisin një opinion për bashkimin për secilin fond për të cilin kryejnë veprimtarinë e depozitarit.

Anëtarët e fondeve të pensionit që bashkohen informohen për planin e bashkimit pasi është dhënë miratimi paraprak nga Autoriteti dhe të paktën 30 ditë pune përpara se të përfundojë hyrja në fuqi e bashkimit.

Anëtarët do të marrin informacionin e nevojshëm me qëllim vlerësimin e saktë të procesit të bashkimit.

Anëtarët e fondeve të pensionit që bashkohen, të cilët vendosin të tërhiqen nga Fondi për shkak të ndryshimit të statusit të Fondit, nuk do të paguajnë penalitete për tërheqje të parakohshme. Në rastin kur anëtarët vendosin të transferojnë aktivet në një fond tjetër të administruar nga e njëjta Shoqëria Administruese ose nga një shoqëri tjetër administruese, transferimi i aktiveve duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga momenti i hyrjes në fuqi të bashkimit. Anëtarët nuk paguajnë komision transferimi.

Ndarja e fondeve

Ndarja e Fondit kryhet kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Fondit transferohen në dy ose më shumë fonde marrëse dhe fondi transferues prishet.

Ndarja e Fondit, duke transferuar të drejtat dhe detyrimet në dy ose më shumë fonde ekzistuese, është ndarje me marrje në dorëzim. Ndarja e Fondit, duke transferuar të drejtat dhe detyrimet në dy ose më shumë fonde, të krijuar për qëllim të ndarjes, është ndarje me themelim.

Fondi me pjesëmarrje të hapur mund të ndahet në vetëm dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të hapur, ndërsa fondi me pjesëmarrje të mbyllur mund të ndahet në fonde me pjesëmarrje të hapur ose fonde me

pjesëmarrje të mbyllur.

Pas realizimit të ndarjes, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit që ndahet.

Pas realizimit të ndarjes, vlera totale e të gjitha kuotave, që zotëron anëtari në fondin marrës, pas ndryshimit të statusit të fondit si rezultat i ndarjes, duhet të jetë e barasvlershme me vlerën totale të kuotave që anëtari zotëronte në fondin e ndarë përpara ndryshimit të statusit.

16.LIKUIDIMI VULLNETAR I SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Likuidimi i Shoqërisë Administruese kryhet vetëm pas miratimit të Autoritetit. Hapja e procedurës së likuidimit vullnetar bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë.

Autoriteti merr vendim lidhur me kërkesën për likuidim brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës së bashku me dokumnetacionin e plotë të kërkuar.

Autoriteti miraton likuidimin vullnetar vetëm nëse gjykon se mund të paguhet të gjitha detyrimet kundrejt pronarëve dhe kreditorëve të Shoqërisë.

Shoqëria gjatë procedurës së likuidimit vullnetar vijon të ekzistojë, në mënyrë që të shlyejë shpenzimet dhe detyrimet kundrejt të tretëve, të shpërndajë aktivet dhe të kryejë veprimet e nevojshme për përfundimin e likuidimit vullnetar.

Pas miratimit nga Autoriteti i raportit të përgatitur nga Likuiduesi, Autoriteti ia heq licensën e dhënë Shoqërisë administruese.

Aktivitet e Fondit të Pensionit që ka nën administrim Shoqëria Administruese, nuk mund të jenë objekt ekzekutimi si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të Shoqërisë Administruese, sipas legjislacionit shqiptar, dhe as të shlyerjes apo të ekzekutimit të pretendimeve kundrejt Shoqërisë administruese.

17.LIKUIDIMI I DETYRUESHËM I SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Autoriteti merr vendim për vendosjen në likuidim të detyrueshëm të Shoqërisë Administruese kur konstaton se ekzistojnë një ose më shumë prej rrethanave të mëposhtme:

- a) Shoqëria nuk është në gjëndje të shlyejë detyrimet e veta brenda afatit;
- b) Shoqëria kryen ose ka kryer veprimtari në shkelje të këtij detyrimi;
- c) Autoriteti gjykon se është vendimi i duhur dhe i drejtë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë e saj;
- d) Kjo procedurë rekomandohet në kuadër të procesit të përfunduar të rimëkëmbjes dhe rehabilitimit.

Autoriteti për të garantuar mbrojtjen e anëtarëve të Fondit, mund të kërkojë që Fondi t'i kalohet një personi juridik tjetër të licensuar si shoqëri administruese për administrimin e fondeve të pensionit privat.

18.KOMISIONE/TARIFA TË VAZHDUESHME QË PAGUHEN NGA FONDI

Fondit do t'i ngarkohen kosto të tjera si më poshtë:

- Komisioni vjetor i administrimit të shoqërisë është tarifa periodike që i paguhet shoqërisë administruese të fondit të pensionit privat, e përlogaritur në bazë të një përqindjeje vjetore sipas vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit. Komisioni vjetor i Administrimit do të mbahet nga Vlera Netë e Aktiveve të Fondit dhe do të jetë deri në masën 1.2% në vit. Komisioni i Administrimit do të llogaritet çdo ditë dhe do të mbahet në ditën e fundit të çdo muaji, si shumë e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës dhe paguhet në 10 ditë të parë të muajit pasardhës. Komisioni i administrimit do të llogaritet sipas formulës:

Komisioni vjetor i administrimit (në %) = 1.2% x vlera neto e aktiveve të fondit të asaj dite / Ditë kalendarike të vitit financiar. Komisioni i administrimit i zbritet të ardhurës bruto të realizuar nga aktivet e Fondit. Në këtë

mënyrë anëtarëve ju përket e ardhura neto.

- Tarifa që i paguhet bankës depozitare dhe tarifa që i paguhet bankës nëndepozitare, e cila përlllogaritet në bazë ditore mbi vlerën neto të aktiveve të dakordësuara ndërmjet shoqërisë administruese dhe depozitarit dhe paguhet në 10 ditore të parë të muajit pasardhës; Komisionet bankare në lidhje me llogarinë e fondit të pensionit, do të llogariten dhe paguhen sipas kushteve të punës së bankës depozitare ose sipas kushteve të dakordësuara në kontratë me shkrim ndërmjet shoqërisë administruese dhe bankës depozitare; Kostot e auditimit vjetor të fondit. Komisioni i auditorit të jashtëm i shprehur në vlerë fikse e përcaktuar në kontratën me shkrim të lidhur me shoqërinë administruese, do të llogaritet në baza ditore duke e pjesëtuar këtë vlerë me ditët kalendarike të vitit financiar dhe do t'i paguhet auditorit të jashtëm sipas marrëveshjes me shkrim ndërmjet palëve;
- Tarifat që i paguhen Autoritetit për Fondin do të llogariten dhe paguhen sipas parashikimeve të rregullores nr. 155, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre", e ndryshuar;
- Kostot dhe komisione për shitblerje të aktiveve të Fondit, në të cilat përfshihen edhe komisionet për transaksionet e kryera me brokerat one off (kosto fikse) ose përqindje mbi transaksion; Komisionet e transaksioneve në instrumente financiare, të përcaktuara në kontratën me shkrim ndërmjet shoqërisë administruese dhe ofruesit të shërbimit, do të njihen si detyrim në ditën e tregtimit (trade date) dhe do të paguhen në ditën e shlyerjes (settlement date).
- Komisione transaksionesh në platformat shumëpalëshe të tregtimit (në Shqipëri ose jashtë); Kjo vlerë fikse e përcaktuar në kontratën me shkrim të lidhur me shoqërinë administruese, do të llogaritet në baza ditore duke e pjesëtuar këtë vlerë me ditët kalendarike të vitit financiar dhe do t'i paguhet sipas marrëveshjes me shkrim ndërmjet palëve;

Shpenzimet zbriten nga të ardhurat apo kapitali i Fondit në bazë ditore dhe diferenca e cila ndryshon çmimin e kuotës, shpërndahet në mënyrë proporcionale me numrin e kuotave në fond deri në momentin e përlllogaritjes.

Shoqëria do të zgjedhë alternativën më të mirë për kryerjen e investimeve, me qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve. Komisioni vjetor i administrimit dhe kostot e tjera si më sipër listuar në një vit kontabël, pra kostot totale që paguhen nga aktivet e Fondit nuk do të tejkalojnë maksimumin prej **1.5% të vlerës neto të aktiveve** të fondit. Shoqëria mund të ndryshojë tarifën e Fondit në përpunje me ligjin dhe rregulloret të dala në zbatim të tij. Komisioni vjetor i administrimit i shprehur në përqindje do të përlllogaritet si totali i vlerës së të gjitha kostove vjetore të listuara të ngarkuara Fondit, pjesëtuar me Vlerën e Aktiveve Neto mesatare të vitit.

Çdo ndryshim në rritje, të komisionive, si dhe përfshirja e ndonjë komisioni të ri, të papërfshira më parë në prospekt, **brenda kufijve të përcaktuar në ligj** konsiderohet si **ndryshim i rëndësishëm** dhe do të reflektohet në prospektin e Fondit, pas miratimit nga AMF. Njoftimi për çdo rritje të komisioneve të zbatuara nga Shoqëria Administruese u njoftohet anëtarëve të Fondit, të paktën 6 muaj përpara hyrjes së tyre në fuqi nëpërmjet adresës elektronike ose me postë normale dhe do të publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë.

Brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, për rritje komisionesh sipas paragrafit më sipër, të këtij seksioni, çdo anëtar i fondit mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit, pa paguar komision transferimi.

18.1 KOMISIONE/ TARIFA QË PAGUHEN NGA ANËTARI

Fondit nuk i ngarkohen kostot të cilat përballohen nga anëtarit, si më poshtë:

- kosto shërbimi për anëtarin për lëshim certifikata dhe vërtetimesh të posaçme;
- kosto të transaksioneve bankare të pagesave për anëtarët;

Komisionet e marketimit dhe të shitjes do të paguhen nga Shoqëria Administruese.

Komisionet bankare të transferimit të fondeve nga shlyerja e kuotave janë përgjegjësi e anëtarit. Shoqëria

Administruese nuk mban përgjegjësi për komisionet bankare që shoqërojnë investimin apo daljen nga Fondi. Shoqëria Administruese do të bëjë përpjekje maksimale për uljen e kostove të transferimit të fondeve me palët e përfshira në proces.

Komisioni i transferimit: Në rastin kur anëtari i Fondit do të transferojë aktivet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër të menaxhuar nga e njëjta shoqëri administruese nuk do të zbatohet tarifë transferimi. Në rastin kur anëtari i Fondit do të transferojë aktivet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër të menaxhuar nga një shoqëri tjetër administruese, tarifa e zbatueshme që mbulon koston e transferimit do të jetë në nivelin 0.5% të shumës së transferuar. Në rastin kur anëtari transferon aktivet në një fond tjetër të pensionit privat, për efekt të llogaritjes së penalteteve në rastin e tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga Fondi i ri, në kohëzgjatjen e anëtarësimit do të përfshihet dhe perioda e anëtarësimit në fondin e mëparshëm.

Komisione të tjera: Përveç komisioneve të sipërpërmendura, Anëtari i Fondit është i detyruar që të kompensojë Shoqërinë Administruese për të gjitha shërbimet shtesë (këtu përfshihet kostoja e dërgimit të pasqyrave shtesë mbi llogaritë individuale me kërkesën e veçantë të Anëtarit, shpenzimet postare, shpenzime të ndryshme bankare, etj).

19. DEPOZITARI

Shoqëria Administruese “Credins Invest” sh.a., ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Banka Amerikane e Investimeve sh.a., me NUIS J91725007P, me seli në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Njësia Bashkiake Nr.10, Kodi Postar 1001, Tiranë, e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitarit dhe të besimit me licencën nr. 14, datë 28.10.1999, si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr.5, datë 3/07/2017 dhe në përputhje me Ligjin 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe Ligjin 76/2023 datë 10/12/2009, “Për Fondet e Pensionit Privat”.

Depozitari është dhe do të vijojë të mbetet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese dhe nga çdo palë tjetër, që ka lidhje me Shoqërinë Administruese.

19.1 Funksionet e Depozitarit janë si më poshtë:

1. Mban dhe regjistron pasuritë/aktivet e Fondit të pensionit privat;
2. Ruan të gjitha instrumentet financiare, të cilat regjistrohen në një llogari titujsh në formë të dematerializuar;
3. Aktivet e Fondit të pensionit, që nuk mund të regjistrohen në llogarinë e titujve në formë të dematerializuar, si dhe instrumentet financiare të materializuara, që i dorëzohen Depozitarit, regjistrohen në llogari të tjera të përshtatshme për këtë qëllim.
4. Fondet cash mbahen në një llogari transaksionesh (llogari e fondit në cash) për qëllime biznesi dhe nuk mund të përdoren për pretendime që lindin ndaj Depozitarit apo Shoqërisë Administruese.
5. Monitoron vazhdimisht flukset e mjeteve monetare të fondit dhe në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga anëtari ose në emër të anëtarit dhe se të gjitha mjetet monetare të Fondit të pensionit janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të Fondit, Shoqërisë Administruese për llogari të Fondit ose të Depozitarit për llogari të Fondit;
6. Mban regjistrin e anëtarëve të Fondit dhe të dhënat për çdo transferim për fondet e pensionit;
7. Mban llogari për aktivet e Fondit të pensionit dhe siguron ndarjen e aktiveve për secilin fond për të cilin ofron shërbimet e depozitarit nga aktivet e Depozitarit dhe klientëve të tjerë të Depozitarit dhe Shoqërisë Administruese;
8. Kontrollon që aktivet e Fondit të pensionit investohen në përputhje me objektivat dhe strategjinë e investimit të miratuar, dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi;
9. Informon Autoritetin dhe Shoqërinë Administruese për procedurën e llogaritjes së vlerës së aktiveve dhe çmimit të kuotës së Fondit të pensionit, konfirmon llogaritjen dhe siguron që llogaritja e vlerës neto të

aktiveve të Fondit dhe çmimi i kuotës së Fondit të pensionit janë kryer në përputhje me politikat e miratuara të kontabilitetit, metodologjitë e vlerësimit, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi;

10. Ekzekuton urdhrat e Shoqërisë Administruese në lidhje me transaksionet e aktiveve të Fondit, nëse nuk bien ndesh me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi;
11. Raporton te Shoqëria Administruese për veprimet tregtare në lidhje me aktivet e Fondit të besuara në kujdestari dhe ekzekuton urdhrat e Shoqërisë Administruese;
12. Garanton kthimin e çdo shume përkatëse Fondit, brenda afateve kohore të përcaktuara;
13. Siguron që të gjitha të ardhurat, që rrjedhin nga transaksionet me aktivet e Fondit, të dërgohen në llogarinë e Fondit brenda afateve të përcaktuara;
14. Garanton se të ardhurat e Fondit të pensionit përdoren në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi;
15. Sigurohet që kostot ose tarifat e paguara nga Fondi i pensionit janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi;
16. Kryen të gjitha detyrat e tjera të parashikuara në kontratën për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit të Fondit të pensionit;

Gjithashtu depozitari është dhe do të vijojë të mbetet tërësisht i pavarur nga shoqëria administruese dhe nga çdo palë tjetër, që ka lidhje me Shoqërinë Administruese.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së depozitarit për disa fonde pensioni, aktivet e fondit dhe regjistrat për secilin fond duhet të ndahen plotësisht si nga njëri-tjetri, ashtu edhe nga vetë aktivet e depozitarit si dhe të dallohen nga aktivet e klientëve të tjerë të depozitarit.

19.2 Përgjegjësia e depozitarit

Depozitari i fondit të pensionit:

1. Është përgjegjës ndaj Shoqërisë Administruese, Fondit të pensionit dhe ndaj anëtarëve të Fondit për çdo humbje të shkaktuar nga vetë ai ose nga një palë e tretë së cilës i është deleguar ruajtja e aktiveve të Fondit.
2. Mban përgjegjësi ndaj Fondit të pensionit dhe ndaj anëtarëve për të gjitha humbjet e shkaktuara si pasojë e pakujdesisë së depozitarit apo mospërbushjes së qëllimshme të detyrimeve të tij në bazë të ligjit nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat" dhe akteve rregullative të miratuara nga Autoriteti.
3. Aktivet e fondit të pensionit nuk mund tu nënshtrohen ekzekutimeve për detyrimet që depozitari ka ndaj të tretëve. Aktivet e fondit të pensionit duhet të veçohen nga aktivet e depozitarit në bazë të së drejtës së veçimit në procedurë falimentimi dhe nuk përfshihen në shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve të depozitarit.
4. Mban njëkohësisht me shoqërinë administruese regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese në lidhje me veprimtaritë financiare në llogaritë e kuotave të anëtarëve në këtë regjistër është në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
5. Duhet të sigurojë që të gjitha transaksionet lidhur me anëtarët e fondit të pensionit, të regjistrohen me saktësi në regjistër. Kjo përfshin pagesën e kontributeve, tërheqjet/shlyerjet e kuotave, transferimet e aktiveve neto të anëtarit në një fond tjetër pensioni dhe/ose te një shoqëri e sigurimit të jetës dhe çdo veprimtari tjetër financiare që lidhet me llogaritë e anëtarëve, duhet të zbatohet masa sigurie për të mbrojtur të dhënat e regjistrit të pronësisë së fondit, për të shmangur aksesin e paautorizuar dhe çdo dokumentacion në të;
6. Duhet të kryejë kontrole të rregullta të të dhënave duke identifikuar dhe korrigjuar çdo mospërputhje apo gabim në regjistrin e pronësisë së fondit, pas komunikimit me shoqërinë administruese, me qëllim sigurimin e saktësisë dhe integritetit të të dhënave që lidhen me anëtarët e fondit të pensionit privat;

7. Duhet t'i raportojë menjëherë shoqërisë administruese çdo mospërputhje ose parregullsi e identifikuar gjatë procesit të verifikimit dhe duhet të ndërmerren veprime korrigjuese pa vonesë;
8. Duhet të raportojë menjëherë në Autoritet çdo veprim të ndërmarrë nga shoqëria administruese që bie në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në rast të ndonjë problemi ose gabimi të identifikuar në regjistrin e pronësisë. Raportimi duhet të përfshijë informacion të detajuar mbi natyrën e problemit dhe masat e marra për ta adresuar;
9. Duhet të zbatojë masa, për ruajtjen e konfidencialitetit së të dhënave të regjistrit;
10. Është përgjegjës për të siguruar që çdo shkëmbim i të dhënave ose komunikim me palët e treta kryhet në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave;
11. Është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sigurt të të dhënave personale dhe financiare të anëtarëve të fondit të pensionit privat;
12. Duhet të sigurojë ndarjen e regjistrit të pronësisë për secilin prej fondeve të pensionit privat që ofron shërbimet e depozitarit;
13. Duhet të ruajë dhe të arkivojë të dhënat e regjistrit të pronësisë duke siguruar që ato të mbahen sipas afateve kohore që parashikohen në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi;
14. Duhet të vendosë dhe zbatojë politika dhe procedura për të parandaluar aksesin e paautorizuar në regjistrin e pronësisë, duke përfshirë enkriptimin, ruajtjen e sigurtë dhe procedurat e aksesit të kontrolluar.
15. Depozitari është i detyruar të ruajë konfidencialitetin për çdo informacion të marrë.

Depozitari i Fondit nuk mund të ngarkojë anëtarin e Fondit me asnjë tarifë apo komision, përveç atyre të parashikuara në këtë Prospekt.

19.3 Konflikti i interesit

1. Depozitari gjatë kryerjes së detyrave të tij, duhet të veprojë me kujdesin e një eksperti të mirë, me ndërgjegje dhe ndershmëri, i pavarur nga shoqëria administruese, aksionarët e saj ose anëtarët e fondit për të cilin kryen veprimtari depozitari.
2. Depozitari ka procedura organizative dhe administrative të përshtatshme dhe efektive, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesit.
3. Depozitari nëpërmjet strukturës së tij organizative dhe akteve të brendshme gjatë kryerjes së veprimtarisë dhe detyrave të parashikuara nga ky ligj dhe kontrata për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit duhet të shmangë konfliktin e interesit midis vetë depozitarit, aksionarëve dhe/ose mbajtësit të pjesëmarrjes influencuese dhe shoqërisë administruese.
4. Konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme nga strukturat përgjegjëse, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interes të anëtarëve të fondit.
5. Shoqëria e licencuar si depozitar nuk zotëron licencë si shoqëri administruese, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri, e cila ka licencë si shoqëri administruese e fondeve.
6. Në këtë rast shoqëria administruese dhe banka depozitare si aksionar i kësaj shoqërie nuk mund të kryejnë funksionet e tyre për të njëjtin fond pensioni.
7. Personat kyç, personeli kyç dhe punonjës të tjerë të depozitarit nuk mund të jenë persona kyç, personel kyç dhe punonjës të shoqërisë administruese dhe anasjelltas.
8. Kur depozitari kryen transaksione me subjekte të lidhura ose persona fizikë të lidhur vendos në zbatim politika dhe procedura të cilat garantojnë se:
 - a) identifikohen të gjitha konfliktet e interesit të lindura nga këto transaksione;
 - b) ndërmerren të gjithë hapat e arsyeshëm për t'i shmangur këto konflikte interesi.

- c) Kur nuk mund të shmangët konflikti i interesit, Shoqëria Administruese dhe Depozitari administrojnë, monitorojnë dhe bëjnë të ditur këtë konflikt interesi, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interesat e fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe të anëtarëve të tij.

Në kohën e përgatitjes së këtij prospekti nuk identifikohet asnjë konflikt interesi në lidhje me Bankën Depozitare.

19.4 Delegimi i funksioneve të depozitarit në lidhje me investimet në monedhë të huaj

Banka Depozitare, për funksionet e kujdestarisë në lidhje me investimet në monedhë të huaj do të përdorë shërbimin e nëndepozitarit në marrëveshje me Shoqërinë Administruese. Funkzioni i nëndepozitarit do të kryhet nga Raiffeisen Bank International AG, me seli qendrore në Vjenë, Austri. Depozitari njofton Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare për marrëveshjen me nëndepozitarin e Fondit.

Pavarësisht këtij delegimi, Banka Depozitare do të mbajë përgjegjësi në lidhje me çdo dëmtim që u shkaktohet aktiveve të Fondit si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të nëndepozitarit. Në kohën e përgatitjes së këtij prospekti nuk identifikohet asnjë konflikt interesi në lidhje me Bankën Depozitare dhe nënkujdestarin.

20. EMRI DHE SELIA E AUDITUESIT TË JASHTËM

Audituesii jashtëm i Shoqërisë dhe Fondeve nën administrim është si vijon:

Shoqëria RSM Albania” sh.p.k., me status aktiv në regjistrin e audituesve ligjorë të regjistruar pranë IEKA, me seli në adresën: Rr. “Skender Luarasi”, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19, 1000, Tiranë

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Kontakt: +355692056532

E-mail: info@rsm.al

Website: www.rsm.global/albania

Persona përgjegjës:

Znj. Elona Bisha – Administrator,

Z. Fatian Devija - Partner Angazhimi

21.PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese është shoqëri aksionare, me afat të pacaktuar në të cilën 76% përqind të aksioneve ose të së drejtës së votës janë në pronësi të një banke, konkretisht Bankës Credins sh.a..

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është 95,822,394.00 Lekë.

Organet drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:

Asambleja e Aksionarëve: e përbërë nga përfaqësuesit ligjorë të aksionerëve,

Banka Credins – 76 % të kapitalit aksionar;

Estela KOÇI – 8 % të kapitalit aksionar;

Egi SANTO – 6.8 % të kapitalit aksionar;

Genc KOXHAJ – 6.8 % të kapitalit aksionar;

Armira ÇITOZI – 1.4 % të kapitalit aksionar;

Vjosa BODO – 1 % të kapitalit aksionar;

Këshilli i Administrimit si organ i vetëm administrimi i cili ushtron njëkohësisht funksionin e administrimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së Shoqërisë (sistemi me një nivel), është i përbërë nga:

1. Znj. Vjosa BODO, Kryetar
2. Z. Eugen NURI, CFA, Anëtar
3. Znj. Estela KOÇI, FCCA, Anëtar
4. Z. Egi SANTO, Anëtar
5. Znj. Armira ÇITOZI, Anëtar

Këshilli i Administrimit kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, të shqyrtojë dhe të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, miraton politikat financiare dhe të investimit, emëron dhe shkarkon administratorët apo anëtarët e Komitetit të Investimit si dhe miraton prospektet e Fondeve nën administrimin e shoqërisë administruese.

Kryerjen e suksesshme të detyrave të mësipërme e mundësojnë eksperiencia dhe kualifikimet e anëtarëve, konkretisht:

- 1) Një titull anëtarësie në Institutin **CFA** (Chartered Financial Analyst-Analist Financiar i Certifikuar) që mbulon menaxhimin e portofolit, fushën e analizës financiare dhe investimeve përkatësisht mbajtur nga Z. Eugen NURI, i cili është me eksperiencë të konsiderueshme në fushën e konsulencës financiare.
- 2) Një titull anëtarësie në shoqërinë globale të ekspertëve kontabël të autorizuar **ACCA** (Association of Certified Chartered Accountants) që mbulon fushën e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, sistemit të kontrolleve të brendshëm, menaxhimit të biznesit, mbajtur nga Znj. Estela KOÇI, e cila ka një eksperiencë të gjatë në fushën e auditimit dhe atë financiare.
- 3) Eksperiencia disa-vjeçare në fushën ligjore e Znj. Vjosa BODO, e cila është zotëruese e titullit **JURIST** që prej vitit 2001, në respekt të diplomës së lëshuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe është poseduese e titullit **AVOKAT** dhe anëtare e dhomës së avokatëve të Tiranës që prej vitit 2003. Gëzon eksperiencë disa vjeçare në projektimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe interpretimin e tyre në institucione qendrore shtetërore dhe në shoqëri sigurimi jete me aktivitet në Shqipëri.
- 4) Eksperiencia bankare e Z. Egi SANTO, sidomos në drejtim të vlerësimit dhe promovimit të burimeve njerëzore, plotëson më së miri gamën e përvojës dhe kualifikimeve të Këshillit të Administrimit të "Credins Invest" sh.a.
- 5) Eksperiencia 25 vjeçare në fushën e financës e Znj. Armira ÇITOZI, e cila është zotëruese e titullit "Kontabël i Miratuar", prej vitit 2005. Znj. Çitozi është një ndër personat kyç në procesin e licencimit të Shoqërisë dhe Fondeve.

Referuar përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 76/2023, datë 21.09.2023, neni 4/sh "anëtarët e Këshillit të Administrimit, nuk janë palë të lidhura ndërmjet tyre, përveçse të qenit pjesëtar/anëtar i Këshillit të Administrimit të shoqërisë "Credins Invest" sh.a.

Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese është Znj. Estela KOÇI.

Zv. Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese është Znj. Armira ÇITOZI.

Administratori i Përgjithshëm dhe Zv. Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë janë njëkohësisht edhe Anëtarë të Këshillit të Administrimit. Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë Administruese, kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë, raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e

politikave dhe rregulloreve të brendshme të shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, vendos mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve, dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara në Ligj.

Komiteti i Investimeve është përgjegjës për menaxhimin e procesit të investimit. Komiteti i Investimeve ndërton një portofol duke marrë vendime për investime që përkojnë me objektivat, kufizimet, vlerësimet e tregut të kapitalit, dhe alokimin e aktiveve, monitoron objektivat e investimit të fondit duke respektuar limitet e alokimit të aktiveve, monitoron performancën dhe shpenzimet e fondit. Komiteti vendos komunikim të vazhdueshëm me Këshillin e Administrimit, anëtarët e fondit, dhe siguron materiale edukuese për anëtarët, rekomandon procedura operationale që forcojnë administrimin e fondit dhe përzgjedh, monitoron dhe nëse lind nevoja rekomandon zëvendësimin e Depozitarit.

Drejtori i Menaxhimit të Riskut kryen analiza të vlerësimit të rrezikut të portofolit të Fondit, të rrezikut që mbartin llojet e ndryshme të aktiveve si dhe vlerëson përshtatshmërinë e aktiveve të zgjedhura për investim në përputhje me objektivat e rrezikut të Fondit. Monitoron dhe raporton mbi ekspozimet e fondit në krahasim me limitet e vendosura. Vlerëson aktivet e fondit sipas legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së vlerësimit të aktiveve, si dhe monitoron likuiditetin e Fondit në përputhje me rregulloret në fuqi. Drejtorja e Menaxhimit të Riskut është nën varësinë e Administratorit të Përgjithshëm dhe raporton pranë Komitetit të Investimeve dhe Këshillit Administrues.

Drejtori i Menaxhimit të Portofolit propozon strategjinë afatgjatë të investimeve në përputhje me horizontin e Fondit dhe të anëtarëve. Kryen analiza financiare dhe analiza të instrumenteve financiare të ndryshme ku investon Fondi. Propozon alokime taktike për investime në llojet e ndryshme të aktiveve ku investon Fondi, brenda një horizonti investimi të caktuar. Zbaton strategjitë dhe vendimet e investimeve të miratura nga Komiteti i Investimeve. Drejtorja e Menaxhimit të Portofolit është nën varësinë e Administratorit të Përgjithshëm dhe raporton pranë Komitetit të Investimeve dhe Këshillit Administrues.

RiskriskriskPersoneli Kyç i Shoqërisë

Znj. Estela Koci – Drejtor, Drejtorja e Menaxhimit të Riskut

Z. Klinti Golemi – Drejtor, Drejtorja e Menaxhimit të Portofolit

Znj. Flonilda Sula – Drejtor, Drejtorja Ligjore, Përputhshmërisë dhe PPP


Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Drejtuesit e lartë të Shoqërisë kanë deklaruar zyrtarisht pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare se interesat e klientëve të Shoqërisë Administruese, nuk do të çënohen nga asnjë konflikt interesi.

Personeli i Shoqërisë Administruese vepron gjithmonë me profesionalizëm dhe vë në zbatim të gjitha njohuritë, në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe të pavarur, pa marrë parasysh interesin personal, duke shmangur çdo situatë që është e prirur për të shkaktuar konflikt interesash.

Asnjë nga personat e Personelit Kyç nuk është drejtor i një shoqërie tjetër ne grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

Organigrama e shoqërisë administruese.

*Këto janë funksione të deleguara



22. DELEGIMI I FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria “Credins Invest” sh.a., ka kryer delegimin e funksioneve në vijim, me qëllimin e vetëm të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së shoqërisë dhe cilësisë së kryerjes së këtyre funksioneve. Administrimi me efektivitet i Fondeve nën administrimin e Shoqërisë, kryhet nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synimin e rritjes së kontributeve dhe investimeve në fondet përkatëse. Nxitja e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aktiveve të Fondeve ka qënë dhe është një nga objektivat kryesore të Shoqërisë. Shoqëria administruese mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen dhe mbarëvajtjen e çdo funksioni të deleguar.

Aktualisht Shoqëria duke marrë nën vlerësim integritetin ligjor, reputacionin, miratimet e kryera nga Autoritetet përkatëse, eksperiencën dhe standardet në ushtrimin e veprimtarive të tyre, ka nënshkruar marrëveshje për delegimin e funksioneve me:

Shoqërinë “Banka Credins” sh.a.

1. Funksionin e marketimit të Fondit, i cili konsiston në ndërtimin e strategjisë/ve përkatëse, dhe politikave të lidhura me administrimin e procesit e marketingut, si dhe me organizmin e bashkërendimin e kryerjes së çdo procesi që lidhet dhe i shërben tërësisht marketingut të fondit.

2. Funksionin e burimeve njerëzore, i cili konsiston në mbështetjen e shoqërisë administruese nga ana e Credins Bank sh.a., lidhur me zhvillimin e politikave të burimeve njerëzore në përputhje me objektivat dhe strategjitë e zhvillimit të saj. Gjithashtu siguron pjesëmarrjen në trajnime të punonjësve të Shoqërisë Administruese “Credins Invest” sh.a., bazuar në politikat dhe manualët e Credins Bank sh.a., për këtë qëllim.

3. Funksionin e prokurimeve dhe të mirëmbajtjes. Funksioni i prokurimeve konsiston në mbështetjen e shoqërisë administruese në kontaktet dhe ofertat me të tretët, furnitorë;

Funksioni i mirëmbajtjes konsiston në mbështetjen e shoqërisë administruese në lidhje me zgjidhjen e problemeve të ndryshme logjistike të shoqërisë, p.sh., riparime të ndryshme, etj.

4. Funksionin e marketingut, i cili i siguron shoqërisë mbështetjen në fushata të ndryshme publicitare si dhe

kontakteve me të tretët, shoqëri reklamuese, organizuese panairesh, konferencash, evente të ndryshme, etj.;

5. Funksionin e teknologjisë së informacionit, i cili mbështet shoqërinë në lidhje me administrimin e sistemeve të serverave si dhe në ngritjen, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e pajisjeve aktive të rrjetit informativ. Gjithashtu i rekomandon shoqërisë kryerjen sipas rastit të investimeve në zgjidhje teknologjike të reja për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese.

6. Funksionin e sigurisë në mjediset e brendshme të Shoqërisë Administruese “Credins Invest” sh.a., për të patur standarde pune të qeta dhe të sigurta;

7. Funksionin për Disaster Recovery, i cili konsiston në mundësimin e infrastrukturës në lidhje me ambientet dhe pajisjet, si dhe kontribuon në planin e rikuperimit të ambienteve të zyrave dhe pajisjeve.

Shoqërinë SiCRED sh.a., me NUIS K42201801Q, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga "Brigada e VIII-të", Vila Nr. 3/1. Shoqëria SiCRED sh.a., është e licencuar dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë fushën e sigurimeve të jetës. Shoqëria operon si një shoqëri sigurimi jete dhe ofron produkte të sigurimit të jetës në përputhje me legjislacionin përkatës.

Shoqëria SiCRED sh.a., do të kryejë funksionin e marketimit të Fondit, i cili konsiston në ndërtimin e strategjisë/ve përkatëse, dhe politikave të lidhura me administrimin e procesit të marketingut, si dhe me organizimin e bashkërendimin e kryerjes së çdo procesi që lidhet dhe i shërben tërësisht marketingut të fondit.

Shoqërinë PCG sh.p.k., me NUIS L61929015I, me seli në adresën Njësia Bashkiake nr 5, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Nd. 6, H. 11, Ap 28, Tiranë. Shoqëria PCG sh.p.k., ushtron veprimtarinë e saj në fushën e asistencës dhe konsulencës, duke ofruar shërbime profesionale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Objekt i aktivitetit të shoqërisë përfshin: asistencë dhe konsulencë në çështje ligjore, fiskale dhe administrative, konsulencë në fushën financiare, bankare, tregtare dhe fiskale, si dhe në fushat e investimeve, zhvillimit të pasurive të paluajtshme dhe tregjeve financiare, përfshirë bursat brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria angazhohet gjithashtu në ofrimin e konsulencës në sektorët e telekomunikacionit, teknologjisë së informacionit, turizmit, ndërtimit, si dhe në fusha të tjera të tregtisë, industrisë dhe zhvillimit ekonomik.

Shoqëria PCG sh.p.k., do të kryejë funksionin funksionin e marketimit të Fondit, i cili konsiston në ndërtimin e strategjisë/ve përkatëse, dhe politikave të lidhura me administrimin e procesit të marketingut, si dhe me organizimin e bashkërendimin e kryerjes së çdo procesi që lidhet dhe i shërben tërësisht marketingut të fondit.

Shoqërinë Stag Consult sh.p.k., me NUIS L62218018E, me seli në adresën Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Komuna e Parisit, Pallati Tirhino, Kulla B, Kati II, Ap. 8 Tiranë. Shoqëria Stag Consult sh.p.k., ushtron veprimtarinë e saj në fushën e zhvillimit të biznesit dhe ofron një gamë të gjerë shërbimesh konsulence dhe asistence teknike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Objekti i aktivitetit të saj përfshin këshillimin në lidhje me informacionin mbi tregun, planifikimin strategjik, bashkimet dhe blerjet e pjesëmarrjeve në shoqëri, si dhe këshillimin ligjor dhe fiskal.

Shoqëria Stag Consult sh.p.k., do të kryejë funksionin funksionin e marketimit të Fondit, i cili konsiston në ndërtimin e strategjisë/ve përkatëse, dhe politikave të lidhura me administrimin e procesit të marketingut, si dhe me organizimin e bashkërendimin e kryerjes së çdo procesi që lidhet dhe i shërben tërësisht marketingut të fondit.

Shoqërinë FF-FB SH.P.K., me numër NUIS M01307017G, me seli në adresën Rruga “Andon Zako Çajupi”, Pall. e Aviacionit të Vjetër, Shk. 5, Ap. 26, Njësia Administrative nr. 5.

Shoqëria FF-FB SH.P.K, do të kryejë funksionin e auditimit të brendshëm që bazohet në programin vjetor të punës, i cili është në përputhje me objektivat e kontrollit, dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit. Ky funksion kryhet i plotë, duke shërbyer si një funksion i pavarur nga veprimtaria e përditshme ekonomiko-financiare, për të kontrolluar dhe vlerësuar aktivitetin brenda Shoqërisë “Credins Invest” sh.a.; Shoqëria FF-FB” është anëtare e IEKAs e krijuar në vitin 2020. Gjatë aktivitetit të saj, kjo shoqëri ka trajtuar rregullisht çështjet e kontabilitetit dhe kontrollit lidhur me instrumentet financiare në fushën e SNK 39, SNRF 9, SNRF 15, SNRF 16 dhe SNRF 17

duke asistuar në përgatitjen e Raportimeve Financiare Vjetore për institucionet financiare të ndryshme banka dhe jo banka.

Kontakt: +355692026226

E-mail: fbeqja@ff-fb.com

Person përgjegjës: Z. Fatos Beqja

Funksionet e deleguara janë miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

23. NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË PROSPEKT

Nëse pas publikimit të prospektit të Fondit dhe gjatë ofrimit të Fondit të Pensionit, ndodhin ndryshime të rëndësishme, që ndikojnë në informacionet që përmban prospekti ose në rast të një informacioni të ri të evidentuar, Shoqëria Administruese bën ndryshimet përkatëse në Prospekt.

Ndryshime të rëndësishme të Prospektit të Fondit janë si në vijim:

- a) rritja e komisionit të administrimit, komisionit të transferimit si dhe përfshirja e një komisioni të padeklaruar më parë në prospekt, brenda kufijve të përcaktuar në ligj;
- b) ndryshimi i objektivave të investimit dhe rreziqeve të lidhura me to;
- c) ndryshimi i profilit të rrezikut të fondit të pensionit ose aftësisë mbajtëse të rrezikut.

Këto ndryshime pasi reflektohen në Prospekt, miratohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Shoqëria Administruese njofton anëtarët e Fondit për ndryshimet e ndodhura, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së miratimit nga Autoriteti, përmes postës elektronike ose me postë normale.

Ndryshimet e rëndësishme të prospektit publikohen edhe në faqen zyrtare të shoqërisë.

Njoftimi për çdo rritje të komisioneve brenda kufirit të përcaktuar në ligj të zbatuara nga Shoqëria Administruese u njoftohet anëtarëve të Fondit, të paktën 6 muaj përpara hyrjes së tyre në fuqi.

Brenda 30 ditëve pune nga data e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, anëtarët e Fondit gëzojnë të drejtën e ndryshimit të Fondit pa paguar komision transferimi.

24. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të Anëtarëve të Fondit të Pensionit dhe punëdhënësve të cilët zgjedhin të kontribuojnë në fondin e pensionit kontribute për punëmarrësit e tyre, të deklaruara në kontratë si dhe/ose në çdo dokument tjetër (formular/pyetësor/deklaratë dhe jo vetëm) të nënshkruar apo deklaruar pranë “Credins Invest” sh.a., do të përpunohen nga kjo e fundit me standardet me të larta të sigurisë në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Shoqëria Administruese do të mbledhë të dhënat personale të Anëtarëve dhe punëdhënësve, të deklaruara nga ana e tyre, si edhe t'i përpunojë më tej ato vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit për të cilin kanë aplikuar pranë shoqërisë. Gjithashtu “Credins Invest” sh.a., do të transferojë këto të dhëna drejt palëve kontraktore të cilat mund të jenë në cilësinë e përpunuesit në kuadër, të çeljes, mirëmbajtjes dhe administrimit të llogarisë. Në këtë kuadër, të dhënat personale do i transferohen Depozitarit të Fondit të Pensionit, bazuar në Ligjin nr. 76/2023, “Për Fondet e Pensionit Privat”, Agjentit të Fondit, në mënyrë që shoqëria të ushtrojë vigjilencën e duhur si edhe të zbatojë detyrimet e tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Shoqëria “Credins Invest” sh.a., pas dakortësisë së dhënë nga Anëtari, në kontratën e anëtarësimi mund të kryejë përpunim të mëtejshëm të të dhënave për një qëllim tjetër, të ndryshëm nga ai fillestar, i përcaktuar në momentin e mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë transferimin ose vënien në dispozicion të të dhënave për këtë qëllim të ri; “Credins Invest” sh.a., do të ruajë të dhënat personale të Anëtarëve dhe punëdhënësve për një afat deri në 5 vite pas mbylljes së marrëdhënies së biznesit mes palëve.

Gjithashtu, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, Anëtari dhe punëdhënësi mund të ushtrojnë në çdo kohë të drejtën për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale që përpunohen nga ana e “Credins Invest” sh.a.. Gjithashtu në çdo kohë ruajnë të drejtën për t’u ankuar tek “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe ruajnë të drejtën për t’u tërhequr nga dhënia e pëlqimit për përpunim e të dhënave.

Ky prospekt i bashkëlidhet kontratës/deklaratës së anëtarësimit në Fondin e Pensionit Privat.

ANEKSI 1 - PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORE

Aktive - janë tituj, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të fondit të pensionit, të shoqërisë administruese apo të depozitarit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”.

AMF - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (“Autoriteti”) I krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Agjent i fondit të pensionit - është personi juridik, i krijuar si institucion financiar dhe i rregjistruar nga Autoriteti për të promovuar fondin e pensionit dhe për të ofruar kontrata anëtarësimi në fondin e pensionit në emër të shoqërisë administruese.

Anëtar - është individ, i cili i bashkohet fondit të pensionit në bazë të një kontrate anëtarësimi me shoqërinë administruese, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në fondin e pensionit dhe që ka të drejtën e përfitimit në të ardhmen nga fondi i pensionit.

Anëtar i mundshëm - është individ, i cili ka të drejtë për tu përfshirë në një fond pensioni.

Auditues i jashtëm - është personi juridik në cilësinë e një shoqërie auditimi, me qëllim auditimin e pavarur të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara dhe ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

Depozitari (banka kujdestare) - është banka e licencuar nga Autoriteti të kryejë si veprimtari ruajtjen e aktiveve të fondit të pensionit privat, dhe detyrat dhe funksionet e përcaktuara në ligjin nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat".

Diversifikim i portofolit - investim i aktiveve të fondit në instrumente të ndryshëm, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga investimi.

Fond pensioni privat (“fond pensioni”) - është një grup i veçuar aktivesh pa personalitet juridik, i miratuar nga Autoriteti dhe i administruar nga shoqëria administruese, për llogari të anëtarëve të fondit në përputhje me dispozitat e Nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”. Fondi i pensionit privat mund të jetë me pjesëmarrje të hapur ose me pjesëmarrje të mbyllur.

Fond pensioni me pjesëmarrje të hapur - është fondi i pensionit i krijuar nga shoqëria administruese, anëtar i të cilit mund të jetë çdo individ, përfshirë punëmarrësit e punëdhënësit, i cili zgjedh të kontribuojë në fondin e ofruar nga shoqëria administruese, pa krijuar një fond pensioni me pjesëmarrje të mbyllur.

Fond pensioni me pjesëmarrje të mbyllur - është fondi i pensionit profesional i krijuar nga një punëdhënës, disa punëdhënës ose një entitet i organizuar si bashkim punëdhënësish, sindikatë apo bashkime sindikatash, shoqatë apo çdo kombinim i tyre sipas një akt krijimi ose marrëveshjeje të rënë dakord midis tyre. Pjesëmarrja në këtë fond është e kufizuar vetëm për punëmarrësit/anëtarët e subjekteve të përmendura në këtë pike.

Fitim nga kapitali - të ardhurat nga diferenca e çmimit të aktiveve.

Këshilli i Administrimit - organi i vetëm i Shoqërisë Administruese me përgjegjësi kryesore për administrimin dhe mbikëqyrjejen sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Kontribues - Anëtari në një fond pensioni, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë, i cili paguan kontributet

e pensionit në llogarinë e pensionit të Anëtarit të Fondit të Pensionit.

Kuotë pensioni - pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e aktiveve të Fondit të Pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të aktiveve të Fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të Fondit të Pensionit, gjithmonë, është e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të këtij Fondi Pensioni.

Kthim nga investimi - rezultati, që merret nga investimi i aktiveve dhe fitimi nga kapitali.

Komisioni vjetor i administrimit - është tarifa periodike që i paguhet shoqërisë administruese të fondit të pensionit privat, e përlogaritur në bazë të një përqindjeje vjetore sipas vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit.

Komision transferimi - është komisioni që anëtari i paguan shoqërisë administruese në momentin e transferimit të aktiveve nga një fond pensioni privat i një shoqërie administruese te një shoqëri tjetër administruese.

Menaxher i portofolit - personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e portofolit të aktiveve të Fondit.

Platforma Shumëpalëshe Tregtimi - është sistemi shumëpalësh i operuar nga një shoqëri komisionere ose një operator tregu sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

Portofol - tërësia e investimeve të kryera me aktivet e fondit.

Pagesat e pensionit – janë pagesat në para, në formë pensioni, të kuotave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, të vlerësuara me çmimin e kuotës të ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje.

Përfitues - është individi, i cili merr përfitime pensioni sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Përfitime (pagesa e pensionit) - janë pagesat në para, në formë pensioni, të kuotave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, të vlerësuara me çmimin e kuotës të ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje.

Persona kyç - janë individët të cilët, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfaqësojnë shoqërinë administruese dhe ushtrojnë funksione drejtuese, përfshirë administratorin dhe anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërisë dhe në rastin e depozitarit drejtuesi i shërbimeve të depozitarit.

Personel kyç - janë individët në poste të larta, të cilët janë përgjegjës për funksionet kyçe të shoqërisë administruese, ku përfshihen: drejtuesi i njësisë së administrimit të aktiveve/investimeve, drejtuesi i njësisë së administrimit të rrezikut, drejtuesi i njësisë së përputhshmërisë, drejtuesi i njësisë së parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm dhe, në rastin e depozitarit, drejtuesi i auditimit të brendshëm, drejtuesi i administrimit të rrezikut dhe drejtuesi i përputhshmërisë.

Fond pensioni i zgjedhur nga punëdhënësi për punëmarrësit - fond pensioni me pjesëmarrje të hapur në të cilin nëpërmjet kontratës ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese, u ofrohen përfitime për pension punonjësvetë këtij punëdhënësi.

Tituj - janë instrumente financiare, të cilat emetohen për qëllime fitimprurëse nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre dhe janë të tregtueshme. Titujt përfshijnë pa kufizim aksionet e emetuara nga shoqëritë aksionare, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të njërive të vetëqeverisjes vendore, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga qeveritë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumentet e tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që përkufizohen si të tilla në ligjin nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Tituj borxhi - janë obligacione ose forma të tjera titujsh borxhi të transferueshëm, me përjashtim të instrumenteve financiare që janë ekuivalente me aksionet e shoqërive tregtare ose që, nëse konvertohen ose nëse ushtrohen të drejtat që rrjedhin nga to, krijojnë të drejtën e blerjes së aksioneve ose instrumenteve financiare ekuivalente me aksionet.

Tituj të transferueshëm - janë ato klasa të titujve, me përjashtim të instrumenteve të pagesës, të cilat janë lirish të transferueshme pa kufizime dhe të negociueshme ndërmjet dy palëve në një treg të rregulluar ose jo.

Transferimi i aktiveve - transferimi i aktiveve nga një fond pensioni në një fond tjetër pensioni.

Rating (vlerësim) i titujve - renditje e titujve, e kryer nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të rrezikut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi. Titujt e klasifikuar A, A2 dhe A3 përfaqësojnë rrezik të ulët e për rrjedhim pritshmëria për kthimin nga investimi është e ulët. Titujt të klasifikuara B, BB dhe BBB përfaqësojnë rrezik mesatar, ndërsa letrat me vlerë të klasifikuara C konsiderohen me rrezik të lartë e për rrjedhim kanë kthimin më të lartë të pritshëm nga investimi.

Shoqëri Administruese e Fondit të Pensionit Privat (Shoqëri Administruese) - një Shoqëri Aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe e licencuar nga Autoriteti, për të administruar një ose disa fonde pensioni.

Vlera neto e aktiveve për kuotë - është vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit e pjesëtuar me numrin e kuotave në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve.

Vlera neto e aktiveve - është vlera e agreguar e aktiveve të fondit të pensionit pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve në momentin e llogaritjes.

Shoqëri Administruese e Fondit të Pensionit Privat (Shoqëri Administruese) - një Shoqëri Aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe e licencuar nga Autoriteti, për të administruar një ose disa fonde pensioni.

ANEKSI 2 - SHEMBUJ ILUSTRATIVË TË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT

Këta shembuj dhe të dhënat e paraqitura në to janë verifikuar nga Znj. Petrina DUKA, Aktuale, e autorizuar/njohur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Normat e kthimit dhe kontributet mujore apo vitet e investimit janë marrë thjesht për qëllime ilustrative.

Shembull 1 (Monedha Lek)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	50,000	Fondet në dispozicion për pension	34,818,145
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit		Shuma e pensionit mujor para tatimit	218,186
Totali i kontributeve	18,000,000	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	11,540,066
Kontributet + Interesat	34,818,145	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	16,818,145
Fondet në dispozicion për pension	34,818,145	Totali i interesave të përfituar	28,358,211
		Tatimi i llogaritur për kthimin nga investimi	4,253,731

Ndryshim në shumën e menjëhershme

Shembull 2 (Monedha Lek)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	100,000	Fondet në dispozicion për pension	72,949,788
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	1,000,000	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit		Shuma e pensionit mujor para tatimit	539,601
Totali i kontributeve	37,000,000	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	24,178,351
Kontributet + Interesat	72,949,788	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	35,949,788
Fondet në dispozicion për pension	72,949,788	Totali i interesave të përfituar	60,128,140
		Tatimi i llogaritur për kthimin nga investimi	9,019,220

Ndryshim në kohëzgjatjen e investimit

Shembull 3 (Monedha Lek)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	50,000	Fondet në dispozicion për pension	18,399,860
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit		Shuma e pensionit mujor para tatimit	136,102
Totali i kontributeve	12,000,000	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	6,098,418
Kontributet + Interesat	18,399,860	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	6,399,860
Fondet në dispozicion për pension	18,399,860	Totali i interesave të përfituar	12,498,278
		Tatimi i llogaritur për kthimin nga investimi	1,874,741

Ndryshim në kohëzgjatjen e pagesës së pensionit

Shembull 4 (Monedha Lek)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	50,000	Fondet në dispozicion për pension	18,399,860
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	5
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit		Shuma e pensionit mujor para tatimit	338,861
Totali i kontributeve	12,000,000	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	1,931,826
Kontributet + Interesat	18,399,860	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	6,399,860
Fondet në dispozicion për pension	18,399,860	Totali i interesave të përfituar	8,331,686
		Tatimi i llogaritur për kthimin nga investimi	1,249,753

Shëmbulli i mëposhtëm i referohet tërheqjes së menjehershme të pensionit:

Shëmbull 5 (Monedha Lek)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesë të menjehershme	
Kontributet Mujore	50,000	Fondet në dispozicion për pension	34,818,145
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Tatimi për tërheqjen e menjehershme	15%
Numri i viteve të investimit	30	Vlera neto e tërheqjes së menjehershme	29,595,423
Totali i kontributeve	18,000,000	Tatimi i llogaritur	5,222,722
Kontributet + Interesat	34,818,145	Interesi i përfituar gjatë fazës së Investimit	16,818,145
Fondet në dispozicion për pension	34,818,145	Totali i interesave të përfituar	16,818,145

Shënim: Këta shembuj janë për llogaritje për qëllime ilustrative dhe nuk përbëjnë garanci apo premtim për shuma apo norma kthimi.

CREDINS INVEST

Credins Invest sh.a., Zyra Qendrore
Rr. “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri

www.credinsinvest.com
contact@credinsinvest.net

Tel: +355 69 60 60 058
Nuis: K52311009R

CREDINS INVEST